1.5 Ngritja e kapacitete ve për vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike dhe legjislacion	ABGJ	I vazhdues hem		Zyr aligjor	Sk a buxhet	1aktivite (trajtime)	Ligji për Barazi Gjinore
1.6 Monitimi i politikave ekzistuese publike (i ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloret)	Zyra ligjore	I vazhdues hem		Zyra ligjore	Sk a buxhet	1Rregullorja per tarifngarkesa komunale 2. Per subvencione DKRS 3.Statuti bibliotekes	Ligji për Barazi Gjinore
1.7 Ngritja e pjesmarrjes se grave ne debate dhe degjimepublike	GG,Kordinat ori i performance s dhe Zyra e informimit	I vazhdues hem		Spot publicitar poster dhe web faqja e komunes	€ 250	1.Degjim buxhetor organizuar vetem 5% eshte rrit pjesmarrja e grave	Nevojë e Komunës
1.8 Sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Drejtoria e bujqësisë	I vazhdues hem		Fletpalosje e Informues e se,web faqja e komune	€ 100	17 grataktime individuale	SKZH: Masa 16: Rritja e Qasjes në Financa për Ndërmarjet Kosovare
1.9 Sensibilizimi për pjesëmarrjen e grave fermere në Shërbime Këshilluese	Drejtoria e bujqësisë	I vazhdues hem		Fletpalosje e informues e, web faqja e komunes	€ 100	20 vizita këshilluese	SKZH: Masa 16: Rritja e Qasjes në Financa për Ndërmarjet Kosovare
1.10 Organizimi i fushatave vetëdijëse për të drejtën në trashëgimi dhe pronë	Abgj,Zyra e kadastrit dhe Noteret	Prill	Dhjetor	Poster dhe fletpalosje	€ 150	4 poster 5Takime informuese 72 gra dhe 18 burra	SKZH: Masa 13 Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore; Strategjia Kombëtare

							re për të Drejtat Pronëso re në Kosovë 2016- 2020
Aktiviteti	Departamenti të cilit i kërkohe për krahe/bas hkëpunim	Data e fillim it	Data e përfun dimit	Burimet e nevojsh me (stafi, pajisjet teknike etj.)	Buxh eti i nevoj shëm	Rezultati	Me cilin Dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë
1.11 Për qindja e grave në pozita vendimma rrëse (nivel drejtues dhe drejtues i lartë) në Arsim Komunal	Kryetari i Komunes dhe DKA	I Vazhdue shëm		monitorim	pa buxhet	45% ne vendimmar je 25% ne arsim	Ligji për Barazi Gjinore
1.14 Zba timi i pakos informues e për edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues për shkollat fillore dhe të mesme	MASHT, D KA .DSHMS dhe shkollat	Në vazhdimë si		monitori m	Pa buxh et	Fushat vetdiesuse me publikun dhe fletushka 102 (51 gra dhe 13 burra) 36 te rinjë	Strategjia Sektorial e e Shëndetësisë 2016-2020; Plani Strategjik për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe Shëndetin
							Riprodhues 2019- 2021; PSAK 2017- 2021
1.15 Mbajtja e aktivitetëve e ndërgjegjësu ese mbi barazinë gjinore për grupin e grave deputete të asambleve komunale	ABGJ, OJQ vendore dhe nderkombetare	Në vazhdimë si		Abgj ,salla ,llap top dhe projektor	Pa buxh et	3 aktivitet 13 Asamble	Ligji për Barazi Gjinore

19	Aktivite per marveshjet e bashkpunimit	4			2	USAID dhe 1 UN-WOMEN dhe NDI
----	--	---	--	--	---	------------------------------

Nr.	Puna	Sasia	Kryer	Pa Kryer	Refuzime	Komente
1	Takimet e Kuvendit te Komunes	12				
2	Takimet e KPF-se	12				
3	Takimet e Komitetit per Komunitete	12				
4	Takimet e KKSBS-se	6				
5	Takime me LMT	2				
6	Puntori per MKDHF	5				
7	Takime MKDHF	3				
8	Takimet e rregullra me ABCJ-ne	4				Trajnime e takime
9	Pergaditja e raporteve per nivelin qendror	8				
10	Takimet me OJQ-te vendore	2				
11	Takimet me OJQ-te nderkombetare	2				
12	Takimet e GGKK	6				
13	Takimet me institucionet e ndryshme	6				
14	Mbledhja dhe analiza e statistikave gjimore	1				
15	Trajnime lidhur me detyrat e punes	3				
16	Aktivitetet	4				UA dhe bashkpunimi me NDI dhe shenimin e datav
17	Rastet per keshillim dhe ndermjetesim	-				
18	Pergatitjae raportit per performanc komun	1				Pergatitja e raportit

## 4.DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

### Sektori i Shërbimeve publike

Gjatë këtij viti të 2023-ës, në DSHPME –në Sektorin e Shërbime Publike janë kryer punë të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e punës se kësaj Drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme në këtë drejtori ishin:

- Pranimi i faturave të shpenzimeve komunale, pranimi i faturave të mallrave dhe shërbimeve, si dhe pranimi i shumë fatura tjera në kuadër të Drejtorisë, po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat e shpenzimeve komunale të Rrymës, Ujit, Telefonit, Mbeturinave.

- Po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat të ndryshme për mallra dhe shërbime brenda sektorit të Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.

- Kryerja e pagesave për punëtorët e zjarrëfikësave dhe faturave të ndryshme për këtë sektor.

- Inicimi i procedurave minimale me zyrën e Prokurimit, për nevojat e zjarrëfikësave në kuadër të – DSHPME.

- Kontakte të shpesha telefonike me Keds-in, Hidroregjionin, Ekoregjionin, PTK-në etj, për nevojat e Komunes, të qytetarëve për zgjidhjen e kërkesave të tyre për mes telefonit.

- Caktimi nëpër komisione të ndryshme për nevojat e komunës.

- Përgaditja e kërkesave të KEDS-it, si dhe qytetarëve për pëlqimet konkrete të tyre.

- Realizimi i vizitave në teren për kërkesa të ndryshme (strehim, kanalizim, ujësjellës dhe infrastrukturë), por gjithmonë me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve, Publike, Mjedis dhe Emergjencë.

- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione,

- Përgaditja e planifikimit të buxhetit sipas kërkesave për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë, sipas kërkesës së Zyrtarit Kryesor financiar etj.

- Raportimi i raporteve mujore për qdo muaj për faturat e paguara dhe të papaguara, për zyrtarin Kryesor Financiar të Drejtorisë së Financave.

- Kërkesa të shpeshta për ndryshime të faturave nga operatorët e ndryshëm, në bazë të kërkesës të cilën e bëjmë ne si Drejtori e Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.

-Takime - konsultime të shpeshta me qytetar, për kërkesat dhe nevojat e tyre.

-Takime-konsultime të shpeshta mes bashkëpunëtorëve dhe Drejtorit për punët e ndryshme në Drejtori.

-Raportime të shpeshta Drejtorit, për shpenzimet e sektorit të zjarrëfiksive, për mirëmbajtjen e veturave, sigurimin e automjeteve, shpenzimet e naftës, si dhe shumë shpenzime tjera të sektorit të zjarrfikësive.

-Takime dhe kontakte të shpeshta me zyrtarin kryesor financiar-ZKF për nevojat e Drejtorisë.

- Bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha sektorët e Drejtorive e në veqanti me Drejtorinë e Urbanizmit, me Zyrën e Prokurimit, me Drejtorinë e Arsimit ( DKA), me Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Katastrit e tjera), pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësia Suharekë “ Eko-regjionin “ njësia Suharekë , KEDS-in , PTK-në etj.

Deri me tash kanë ardhur në drejtorinë 347 kërkesa të ndryshme, 169 kërkesa janë miratuar(48.07 %), 145 është refuzuar(41.08%), hedhur posht 5 (1.4%), 1 e pezulluar (0.3 %), 4 janë deleguar me aktpercjellsa ne drejtori te ndryshme(1.2%),2 jan anuluar (0.6%), 21 sosh janë në proces (6 %).

Pastrimi i rrugëve lokale, 123,786 m’

Larja e rrugëve lokale dhe trotuareve duke bere larjen e tyre nga mbeturinat, 86,987.13 m’

Mirembajtja dhe pastrimi i shesheve, parqeve, shtigjeve të ecjes dhe lapidarëve, 75,675 m2

Pastrimi dhe mirembajtja e gjelbrimit ne varreza, 186,666.68 m2

Mirembajtja e gjelbrimit ne parqe, sheshe, shtigje të ecjes dhe pergjate brezit rrugor, 173,172 m2

Ujitja e hapsirave te gjelbrimit, luleve dhe drunjeve dekorativ ne te gjitha hapsirat publike, 15,567.50 m2

Mirembajtja dhe pastrimi i shtratit te lumit ne zonen urbane, 2000 m’Mirembajtja dhe pastrimi i hapsirave publike (te perbashketa) ne objektet shume banesore 32 cope(gjdo muaj që mirëmbahen 192).

Largimi I mbeturinave shtazore, 117 copë.

Largimi i mbeturinave shtepiake vëllimore 193.67 t,

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve lokale nga Bora me 153 km’

Eliminimi i deponive ilegale në Komunë, deri me tani janë pastruar 26 deponi,

Deponi te vogla, te mesme dhe te medha janë 2020 m3, hapja e kanalave per gjate deponive 915.40 m’ si dhe orë pune të makinerive të ndryshme.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale, nga ky projekt deri me tani kemi pasur disa intervenime, ku pjesa dermuese e kesaj kontrate ka qenë me kujdestari.

### **-Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale në Komunë nga bora**

Gjithashtu takimet e rregullta pune kanë vazhduar për një performancë dhe punë sa më të mirë të drejtorisë të organizuara nga Drejtori me stafin për koordinimin për përfomancë komunale.

Bashkëpunimi në mes Komunës së Suharekës dhe **JICA Japoneze** ka vazhduar edhe këtë vit “Projekti për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndosh-Faza e dytë”. Komuna e Suharekës është duke vazhduar në fazën e implementimit të projektit ku ka dërguar rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave (PP4), por e njëjta nuk ka kaluar në asamblenë komunale. Kjo rregullore është ndihmuar nga ekipi i JET dhe zyrtarëve komunal, ku mendohet që në muajt në vijim të miratohet.



*Në kuadër të Projektit për Ngritjen e Kapaciteteve në Menaxhimin e Mbeturinave drejt një Shoqërie të Shëndoshë i Ciklit Material-Faza 2 kanë zhvilluar vizitë studimore në Japoni Drejtori dhe zyrtari I lart për menaxhimin e mbeturinave (13-23 qershor 2023) ku:*

**Qëllimi i vizitës studimore ishte:**

Për të kuptuar gjendjen aktuale të Ekonomisë Qarkore të Japonisë

- Ligjeratë për të mësuar mbi gjendjen e administrimit të menaxhimit të mbeturinave në Japoni
- Vizitë në terren në objektet/hapësirat e menaxhimit të mbeturinave në qeveritë lokale japoneze dhe shkëmbim mendimesh.



Vizitë e në kuadër të trajnimit për menaxhimin e mbeturinave duke parë nga afër se si funksionon grumbullimi, transporti, ndarja, riciklimi, djegia e deri te shëndërimi i tyre në energji elektrike si dhe vizitë në katër impiante në qytete të ndryshme të Japonisë.

### **Fuqizimi i Veprimit Lokal Klimatik (SLCA)**

Komuna Suharekës në partneritet me UNDP dhe Institutin INSI mbas takimit i drejtorive të Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike me përfaqësuesit e kompanisë INSI, takim i koordinuar nga Qendra Komunale për Zhvillim të Gjellbër në Suharekë.

Qëllimi i takimit ishte koordinim rreth analizës dhe përcaktimit të pikave të matjes, si proces nismëtar duke synuar cilësinë e të dhënave për zhvillimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm.

Hartimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm zbatohet në kuadër të projektit "Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën", projekt i zbatuar në partneritet me UNDP në Kosovë.

**Ku** Komuna Suharekës në partneritet me UNDP dhe Institutin INSI, i ka montuar këto paisje për matjen, si proces nismëtar duke synuar cilësinë e të dhënave për zhvillimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm. Këto paisje do të shërbejnë për matjet e hyrje daljeve në qytet, shpejtesinë mesatare të automjeteve. "Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën".



Po ashtu gjatë kësaj periudhe është mbajtur në eventin e Projektit "Fuqizimi i Veprimit Lokal Klimatik (FVLK)", që shënon progresin e Komunës së Prizrenit dhe Suharekës me 10 maj 2023.

Ngjarja do të ofrojë një përvojë unike dhe gjithëpërfshirëse për të pranishmit, duke paraqitur rezultatet, raportet dhe planet komunale të zhvilluara me mbështetjen e projektit, duke prezantuar një model të replikimit për komunat e tjera.



**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)** është duke zhvilluar projektin: "Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e rrezikut nga vërshimet për të gjitha pellgjet e lumenjve në Kosovë, Flood Risk Maps and Flood Hazard Maps for All River Basins in Kosovo", financuar nga WBIF (Grant code-WB25-KOS-ENV-02-për sigurimin e të dhënave dhe informacioneve institucionet e përfshira nuk duhet të kërkojnë mjete materiale, pra të dhënat dhe informacionet duhet të jepen pa pagesë), dhe është në fazën e grumbullimit të të dhënave dhe informacioneve në aspektin e resurseve ujore. Andaj për shkakë të skjarimit të të dhënave me ekspertët e projektit **Ekspertet kan përzgjedhë komunën e Suharekës** vizitë gjithë ditore në drejtoritë e ndryshme të komunës, duke përfshirë departamentet e përfshira me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, shërbimet urbane (kullimi i ujit, furnizimi me ujë, mbeturinat, menaxhimi i ujërave të zeza, etj.), ekonomia në përgjithësi dhe në veçanti ndërmarrjet, banorët e komunës dhe komuna/vendbanime, transport. (30.03.2023).



Drejtorja e Shërbimeve Publike, Drejtorja e Inspeksionit bashkë me punëtor komunalë, të rinj vullnetarë dhe qytetarë shënuan Ditën e Tokës me aktivitete të shumta. Është i domosdoshëm kujdesi ndaj natyrës, ambientit dhe shëndetit. (28.04.2023)



Takime bashkëpunimi kanë vazhduar edhe këtë vit me LMT-austriake, ku u diskutuan shumë çështje lidhur me menaxhimin e emergjencave, ku kërkesë e drejtorisë tonë ishte që të gjindet një formë bashkëfinancimi ose donacioni për një automjet zjarrfikës me shkallë hidraulike gjë për cilin Komuna jonë ende nuk e ka, dhe është tejet i nevojshëm. (23.05.2023)



**Me qëllim të realizimit të projekteve në mënyrë sa më efektive bashkëpunimi është edhe me Hidroregjionin Jugor-Njësia Suharekë, ku kemi pas edhe takime pune. (09.06.2023).**

### **Inspektori I preventives së Zjarrit**

Edhe këtë vit duke u bazuar ne planin vjetor të punës, periudha gjashtëmujore e ketij viti ka kaluar në kryerjen e punëve të lemisë së parandalimit të zjarrit, të kryerjes të inspektimeve të rregullta, të inspektimeve kontrolluese, daljes në vendin e ngjarjes me rastin e zjarreve, dhe punë tjera të mbrojtjes nga zjarri. Kontakti me njerëz, puna në teren, me udhëheqës të ndërmarrjeve apo kompanive të ndryshme, përveq rolit inspektues e ka edhe rolin këshillues dhe edukativ, në shërbim të parandalimit të zjarrit, shpëtimit të pasurisë dhe jetës së njerëzve. Sa i përket zjarreve dhe daljeve në vendin e ngjarjes, duhet



potencuar se per dallim nga vitet e meparshme, kemi pasur dy shkaktime te qellimshme te zjarri të një shtepie dhe nje objekti pushues në bjeshken e Bukoshit.Një zjarr i cili ka ndodhur në bazën e asfaltit në zonën industriale, është fikur dhe neutralizuar i cili do të kishte pasoja të mëdha për ambientin dhe objektet përreth.

Në kuadër të senzibilizimit të qytetarëve për masat parandaluese nga zjarri, do të bëjmë shpërndarjen e një Apeli nëpër të gjitha fshatrat e komunës si dhe të ndërmarrjeve të ndryshme që të marrin masat parandaluese nga zjarri në sezonin e verës, duke i përdorur edhe mediat si mjet i rëndësishëm në senzibilizimin dhe parandalimin e zjarrit.Një vend të rëndësishem zen edhe sezoni i korrje shirjes me kontrollimin e autokombajnave mbi gjendjen e tyre teknike,dhe posedimin e pajisjeve zjarrefikese.

Më poshtë do të evidentoj punët të cilat janë kryer në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2023 duke u bazuar në Planin vjetor të punës.

1. Inspektime të rregullta.....	45
2. Në sektorin Publik.....	5
3. Në sektorin privat.....	40
4. Inspektime kontrolluese .....	33
5. Masa të shqiptuara .....	120
6. Aktvendime .....	0
7. Pëlqime ne dok.investigativ teknik.....	26
8. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve .....	18
9. Vërtetime.....	6
10. Goditje rrufeje.....	2
11. Shkresa për drejtoritë komunale dhe institucionet tjera. ....	10
12. Shpërndarje e Apelit nëpër fshatra, mbi masat e shtuara të mbrojtjes nga zjarri gjatë sezonit të verës.....	1
11. Raporte.dhe shkresa tjera .....	8
12. Raport mbi dëmet e shkaktuara nga erërat në disa fshatra.....	1



Disa fotografi nga inspektimet nëpër objektet shkollore Kalldaja e Nxemjes dhe hidrantet në shkollë



Disa fotografi lidhur me rastin e zjarrit në Duhël,



dhe Zonën Industriale në Shirokë (mobileria Naseri) në Shirokë



**-Sektori për infrastrukturë-**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, sipas procedurave ligjore janë përgatitur dokumentacionet për Projektet Kapitale për vitin fiskal 2023. Janë bërë fillimisht sistematizimi i dokumentacionit të vitit paraprak të projekteve, përgatitje të dokumentacioneve si dhe kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve për inicim të procedurave, zotimi i mjeteve si dhe hartimi i projekteve për projektet kapitale të vitit fiskal 2023 dhe atë:

				Asfalt	Kubëza	Kanalizim		Ndriqim	Trotuar	Hapësirat publike	Sanimi I rrugëve
Emri i Projektit											
			<b>TOTALI</b>	144,741	93,176	37,442		4,176	6,120	-	66,033
Vendbani met	KO DI	TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE 2023-2025	Vlera e Kontraktës	m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	m'		m'	m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>
		Shërbimet Publike, Mjedis, dhe Emergjencë									
1	Baqevc	52488 Ndertimi i rrugës "Varrezat" në Baqevc.	4,805.00 €								

N  
R.

2	Bllacë	523 34	Ndërtimi i rrugëve lokale " Bregu", "Koretniku", "Bashkim Suka"-vazhdim, "Bllacjanët", "Dukagjini", "Mehmet Suka", "Beteja e Bllacës"-Faza e dytë dhe ndërtimi I rrugëve lokale Vlora, Prrocka, Mrizet,Kroi I shelqes,Malsia,rruga Livadhet, Lama Mehmet Lumi-degzim dhe rruga Bislim Zekolli degzim	100,412 .45 €		7,350. 00							
3	Breshancë		Ndërtimi i rrugëve lokale, segment i rrugës „Parajsa”.	5,277.0 2 €		260.0 0							
4	Budakove	523 36	Ndërtimi i rrugëve lokale, Bjeshka e Budakovës, Mehmet Xhafa, Mujë Buzhala, vazhdim, Kodra e thatë	113,957 .08 €	6,695. 00	2,100. 00							
5	Bukoshe		Ndërtimi i rrugëve lokale, Ndërtimi i rrugëve "Hazir Limoni", „Hasan Dulla", "Ukë Bralium", „Izet Halili" „Zelfije Sopa" .	36,267. 42 €		1,785. 00							
6	Delloç		Ndërtimi i rrugëve lokale, "8 Marsi" dhe "Gjirokastra 2"										
7	Doberdelan	523 39	Ndërtimi i rrugëve lokale, Rregullimi i rrugëve; "Sejdi Fejza", "Aziz Limoni", "Apollonia", "Halil Hasani"."Latif Gallopeni".	68,356. 56 €		4,831. 00							
8	Dragaqine	528 29	Ndërtimi i rrugëve lokale "Martiret e Dragaqinës"ne Dragaqinë .	5,951.0 4 €		350.0 0							
9	Dubravë		Ndërtimi i rrugëve lokale, "Sejdi Ramadani"-vazhdim, "Adem Rustemi"-vazhdim;"Hajdar Isufi"-vazhdim; "Jetish Limani"-vazhdim dhe ndërtimi I rrugëve lokale Malokajt segment, vazhdimi rrugës Faik Maliqaj,vazhdim I rrugës Adem Rustemi	18,480. 15 €		1,155. 00							

10	Duhel		Ndertimi i rrugëve lokale "Shote Galica" segment "Sherif Qatani" segment dhe "Vëllëzrit Qatani".	23,870.10 €		1,575.00						
1	Dvoran		Ndertimi i rrugëve lokale "Diga", "Qamet", "Shpend ibrahini"-segment.	23,386.01 €		1,102.50						
1	Gelance		Ndertimi i rrugëve lokale "Azman Alija", "Kodra e Nures" vazhdim, "Fisniket", "Qershia", "Daut Rexhepallari" Vazhdim „Gani Kukaj" vazhdim-Faza e dytë dhe ndërtimi I rrugëve lokale Gani Kukaj segment, Sherif Qadraku segment, Qershija segment	24,864.61 €		1,365.00						
1	Gjinoc		Ndertimi i rrugëve lokale „Besim Neziraj" segment „Jetush Berisha" dhe "sherif Aga", Pavarësia - segment, Esat Rexhepi, Lugjet e Verdha - segment dhe ndërtimi I rrugëve lokale "Te varrezat"- Topliqan	68,432.92 €		5,500.00						
1	Grej koc	523 44	Ndertimi i rrugëve lokale „Rexhep Zmajlaj", „Shaban Rexhepi", „Dan Hyseni", Rexhë Kokaj" dhe "Rrustem Rexha" ,shaban Lushaj", dhe"Beqir Fejza", në Grej koc .	74,822.21 €		3,412.50						
1	Grej qevc		Ndertimi i rrugëve lokale „Hajriz Xhema", „Tetë Vëllëzërit", „Seferi" -Faza e dytë dhe ndërtimi I rrugëve lokale Vazhdim I rrugës Seferi, Dy Martir, Veterani Grej qevc Ritender	86,730.71 €	2,703.75							
1	Javor		Ndertimi i rrugëve lokale, " Smajl Sadria", "Isuf Meta", "Fejz Koliqi"	34,885.52 €	1,545.00	1,050.00						
1	Kasterc		Ndertimi i rrugëve lokale "Sahit Hajdari-vazhdim,"Blerim Raka".	37,975.47 €	2,575.00	787.00						





36	Qytet SUHAREK E	527 14	Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugen "Skenderbeu"- Suharekë	929,426 .34 €	10,935 .86	2,358. 40	2,436. 00		2,436. 00	2,358. 40		
3	Sallagrazh dë	524 30	Ndërtimi i rrugëve lokale „Rrahman Ndrecaj" dhe "Gegaj" në Sallagrazhdë	17,257. 90 €		1,470. 00						
3	Samadraxhë	523 64	Ndërtimi i rrugëve lokale, Ndërtimi i rrugës; "Bunari i Limanit", "dhe "Fehmi Morina"-vazhdim, faza e dyte Ndërtimi I rrugëve lokale Durrësi, Tropoje, Nora e Kelmendit Morea degezim, Feim Morina	79,009. 56 €		4,305. 00						
3	Komunë	525 32	Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve në Komunë" Suharekë, Samadraxhë, Bllacë, Sllapuzhan, Peqan, Semetisht, Reshtan, Studençan, Kastërc .(2kontrata)+1kontratë( punë shtesë)	457,708 .20 €	600.00		34,979 .00					2,200. 00
4	Komunë	525 33	Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve lokale " "Sopijë-Vraniq" dhe "Reqan-Bukosh".	318,064 .50 €	46,170 .00							42,750 .00
4	Savrovë	523 66	Ndërtimi i rrugëve lokale „Imer Munish Rama" „Livadhet e buta" „UÇK" „Rifat Zenelaj" në Savrovë ritender	13,970. 55 €		1,150. 00						
4	Semetisht		Ndërtimi i rrugëve lokale „Besa bese" „Ukë Bytyqi" dhe "Demush Rama".									
4	Sopijë		Ndërtimi i rrugëve lokale "Kodra e Thate" vazhdim, "Nderi I Kombit" segment	104,886 .70 €		5,935. 00						
4	Stravuçinë		Zgjerimi i rrugës kryesore "Isa Morina".									
4	Studençan	524 32	Ndërtimi i rrugëve lokale, Ndërtimi i rrugëve, "Eqerem Qabej"-segment. "Djerrinat", "Gurra e Fshatit", "Brezi i Artë", "Ararët", "Arat "dhe "Arif Gashi".	114,327 .84 €		5,250. 00						



46	Sllapuzhan	524 34	Ndërtimi i rrugëve lokale "Naim Basha", -segment, "Idriz Elshani", dhe Ruzhdi Elshani"-segment .	49,047. 70 €	2,420. 00	1,837. 50					
47	Shirokë		Ndërtimi i rrugëve lokale "Besim Nrecaj"-segment në Shirokë.								
48	Tërrnje	523 70	Ndërtimi i rrugëve lokale, „Marsi i martireve" segment dhe "25 Marsi"-segment.	54,223. 95 €		4,500. 00					
49	Komunë	525 44	Ndërtimi i shtrëterve të lumit "Toplluha" dhe mirembajtja e tyre.	60,050. 00 €							
50	Komunë	525 47	Ndërtimi i trotuarëve dhe parkingjeve në qytetin e Suharekës (Deshmoret e Kombit), Duhël, Krushicë, dhe Mohlan.	162,280 .00 €	2,000. 00	3,000. 00					2,000. 00
51	Vershec	495 77	Ndërtimi i rrugëve lokale „Ushtari I Lirise" segment në Vershec .	5,893.6 0 €	370.80						
52	Vraniq	525 49	Ndërtimi i rrugëve lokale "Muqa"-vazhdim, "Zaim Muqa"-vazhdim, "Adem Kolgeci"-aneks" dhe "Martiret e Vraniqit" në Vraniq .								
53	Komunë	525 51	Ndërtimi i zonave të gjelbruara dhe rekreative në Delloc, Vraniq, Duhël dhe Nishor (2 kontrata).	58,638. 00 €				240.0 0			
54	Komunë	523 71	Ndërtimi i urave në Semetisht, Mushtisht dhe Komunë .	81,398. 00 €							
55	Komunë		Ndërtimi i rrjetit të ujës jellsit në fshatrat „Papaz, Sllapuzhan dhe Bllacë.								
56	Komunë		Ndërtimi i rrugës Peqan i Vogël-Semetisht {2 kontrata}	195,110 .00 €	1,600. 00	3,750. 00	27.00	1,500. 00	3,750. 00		
57	Komunë	523 74	Ndërtimi dhe asfaltimi i unazës në Samadraxhë .	164,650 .32 €	17,670 .00						19,083 .00
58	Komunë	523 75	Ndërtimi i rrugëve lokale "Te varrezat" në Topliqan .(kontrata me Gjnoc)								
59	Komunë		Ndërtimi i rrugës Samadraxhë-Tërrnje-Studenqan .	177,517 .00 €	10,800 .00						
1	ASFALLT (m²)		144,741.00								

2	KUBËZA (m <sup>2</sup> )	93,176.00		
3	KANALIZIMI (m')	37,442.00		
4	NDRIÇIMI (m')	4,176 .00		
5	TROTUAR (m <sup>2</sup> )	6,120.00		
6	SANIMI I RRUGËVE (m <sup>2</sup> )	66,033.00		

Projektet të cilat janë të kontraktuara në vitin: 2020, 2021 dhe 2022 të cilat janë kontrata shumëvjeqare janë duke u menaxhuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë dhe punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike dhe pas krijimit të kushteve atmosferike, punimet vazhdojnë edhe në vitin 2023. Si dhe është bërë menaxhimi i projekteve të cilat janë: Projekte me Bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës:

- Asfaltimi i rrugës lokale nga kryqezimi i rrugës Nacionale N25-Grejkoc -Rrafshi i Livadheve
- Ndërtimi i unazës – Krahu i djathtë – Suharekë
- Ndërtimi i rrugës Sopi – Shirokë ( Rrethrotillimi Leshan L – 5850 M
- Asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Ngucat ( Rruga Bashkim Gashi) - (Lagja Zekolli), Suharekë
- Ndërtimi i rruges Mushtisht - Verbeshticë - Shtërpçë

Janë përgatitur projektet për aplikim për Grande Qeveritare gjegjësisht për aplikim në:

- Ministrinë e Zhvillimit Rajonal
- Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Gjatë kësaj periudhe është punuar në bashkëpunim me UNDP, në projektin, Fuqizimi i veprimit lokal për klimën”, i cili mbështetet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Komuna e Suharekës dhe Komuna e Prizrenit.

Poashtu janë bërë vizita të punimeve të cilat janë duke u zhvilluar në teren si dhe vizita sipas kërkesave të qytetarëve.

Përgatitja e referencave për punët e kryera sipas kontratave, të kërkuara nga Operatorët Ekonomik.

## Spektori për Mjedis

Përmes kësaj shkrese ju raportojmë se Zyrtari për Mbrojtje të Mjedisit gjatë muajve tëlartëpërmendur të 01.01.2023-08.08.2023 ka kryer aktivitete të cilat kanë qenë të parapara me kontratë dhe sipas përshkrimit të vendit të punës si dhe detyra tjera shtesë jashtë përshkrimit të vendit të punës.

Zyrtari për mbrojtje të mjedisit kryesisht është marrë me:

- Përgjegje në shkresa të ndryshme mjedisore, mvarësisht nga karakteri i tyre.
- Përcjellje të proceseve dhe planeve të ndryshme me karakter mjedisor.
- Dalje në teren për lëndë të caktuara dhe monitorim të projekteve.
- Përgatitja e LMK-ve sipas kërkesave të palëve , ku janë regjistruar 6 LMK.( Tri të përfunduara)
- Përgatitja e Pelqimeve në parim sipas kërkesave, ku janë regjistruar 2 pëlqime ( 2 të përfunduara)

Ndërsa nga data: 08.08.2023 Spektori i Mjedisit kalon tek Drejtoria e Urbanizmit

## Menaxhimi i mbeturinave

Në kuader të menaxhimit të mbeturinave, zyrtari nga ky sektor ka raportuar në Agjencionin për menaxhimin e mbeturinave, ku për herë të parë në procedur të rregullt ON-Line, në AMMK.

Po ashtu, nga Grandi i performances, Komuna e Suharekës ka përfituar 558 kontinjer 120L, të cilat janë duke u shpërndarë për kryesi të fshatrave të komunes sonë.

Momenti i pranimit-dorëzimit të kontinjerëve 120L

Stoku i kontinjerëve



### -Sektori për Emergjencë

Në pjesën e parë të këtij viti është dhuruar një donacion shumë i arsyeshëm nga Vëllezërit Gegaj nga Studençani që jetojnë dhe punojnë në Gjermani. Ata Njësisë së Zjarrëfiksëve në Suharekë i kanë dhuruar një kombibus, ku Kryetari Muharremaj dhe drejtori Shabani i falenderuan jashtëzakonisht shumë pasi që ky donacion është i një rëndësie tejet të veçantë për komunën tonë.



### Raporti vjetori NJPZSH për vitin 2023

Raport i intervenimeve 01.01.2023 - 26.12.2023

Realizimi i numrit të përgjithshëm të interven, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2023									
2023	Nr.i përgj.	Nr.i	Nr. i	Nr.i	Aksident e	Vërshim e	Të	Të lënduar	Të vdekur

	i daljeve	zjarreve	Teknike	shërbimeve	rrugore		rejs h	zj .	qyt .	tot	zj .	qyt .	tot
Janar	10	7	1	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	13	10	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	19	15	0	3	0	0	0	0	1	1	0	0	0
Prill	18	10	1	2	4	0	1	0	5	5	0	0	0
Maj	13	3	4	5	1	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	18	10	4	3	1	0	0	0	5	5	0	0	0
Korrik	35	23	3	7	2	1	0	0	1	1	0	0	0
Gusht	85	75	4	4	2	0	0	0	4	4	0	0	0
Shtator	92	84	2	3	3	0	0	0	5	5	0	1	1
Tetor	89	82	0	3	3	0	1	0	1	1	0	0	0
Nëntor	14	8	3	0	2	1	0	0	3	3	0	0	0
Dhjetor	14	12	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	420	339	22	33	21	3	2	0	25	25	0	1	1

## 5.DREJTORIA PËR BUJQËSI ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari gjatë 12 mujave vitit 2023 ka vazhduar punën me angazhime maksimal në realizimin e obligimve dhe detyrave me të cilat ngarkohet në sektorët e saj.

Gjithashtu edhe sfida dhe problem të shfaqura gjatë këtyre 12 mujave.

Ka filluar puna në teren tek shumica e projekteve kapitale të parapara për vitin 2023.

filluar puna në teren tek shumica e projekteve kapitale të parapara për vitin 2023.

Projeketet kapitale që janë realizuar gjatë këtyre 12 mujave te vitit 2023 janë:

1. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore për Bujqësi dhe Pylltari.
2. Ndërtimi i infrastrukturës për turizem në bjeshkën e Vraniqit.
3. Projekti me bashkëfinancim me IADK për ngritjen e pemishteve me dredhëza.
4. Projekti me bashkëfinancim me PPSE dhe fianishten BES JET në fshatin Nepërbisht
5. Ndërtimi i sistemit të ujitjës për sipërfaqet bujqësore në Komunë (punimet janë realizuar në fshatin Nepërbisht dhe fshatin Mushtisht).
6. Furnizimi dhe Ndërtimi i Serave.
7. Furnizimi me mekanizem bujqësor
8. Ndërtimi i vendkampingjeve turistike në Mushtisht dhe shtigjet e ecjes.Ky projekt është në realizim e sipër pasi aktualisht kemi nderpre punimet përshkakë të kushtve jot ë mira atmosferike dhe terrenit të vështir që është në bjeshkën e Dellocit dhe Mushtishtit.

9. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore për Bujqësi dhe Pylltari është projekt në realizim e sipër. Ky projekt pritet të përfundoj në 3 mujin e vitit 2024, përshkakë të kushteve jot ë mira atmosferike.

### **SUBVENCIONET e Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari**

Në kuadër të projektetve të realizuar me Subvencione si Drejtori për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, kemi bërë subvencionimin e qumshtit me 0.03 cent për fermerët blegoral.

Në Korrik të këtij viti kemi hapur thirrjen për aplikim për subvencionim të qumshtit për 6 mujin e I-rë të vitit 2022, ku kanë përfituar gjithsej 62 fermer.

Poashtu kemi bërë edhe subvencionimin e qumshtit edhe për gjashtëmujin e parë të vitit 2023, ku përfitues kanë qenë 61 fermerë të cilët kanë aplikuar në thirrjen publike të cilën e ka shpall Drejtoria.

Ndërsa për gjashtëmujin e vitit 2023, hapim thirrje në pjesën e parë të vitit 2024, pasi fermerët deri me datë 31.12.2023 vazhdojnë të bëjnë dorzimin e qumshtit në pikat grumbulluese.

### **Projekt tjetër nga Subvencionet e Drejtorisë për BZHRP është**

**Furnizimi me mekanizëm Bujqësor, ku këtë vit kemi subvencionuar fermerët me 3 lloje të mekanizmit bujqësor;**

1. Spërkatëse
2. Motokultivator
3. Maqinë për qethjen e deleve

Drejtorja për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari ka hapur thirrjen publike në të cilën kanë aplikuar numër i konsiderueshem i fermereve, ndërsa sipas buxhetit të paraprirë për këtë projekt kemi shpërndarë;

79 Spërkatëse

142 Motokultivator

18 Makina për qethejje e deleve

### **Nga Subvencionet e Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari është edhe projekti "Furnizimi dhe montimi i Serave"**

Ky projekt është realizuar me shumë sukses ku janë ndërtuar gjithsej 67 sera të llojeve dhe sipërfaqeve të ndryshme.

Llojet e sipërfaqeve të serave janë me këto dimensione.

1. 5 Sera me nga 500 m<sup>2</sup>
2. 5 Sera me nga 200 m<sup>2</sup>
3. 57 Sera me nga 100 m<sup>2</sup>

Vlera e projektit "Furnizimi dhe montimi i Serave" është 128,613.00 €.

## **Bashkfinancim me IADK**

Kemi realizuar me sukses projektin me bashkëfinancim me IADK për periudhen 2023-2025 për realizimn e projektit “Përmirsimi i punësisimit dhe mundësive për gjenerimin e të ardhurave në zonat rurale të Kosovës. Poashtu kemi mbajtur session infomues për këtë projekt në sallën e Kuvendit Komunal. Poashtu është hapurr thirrja nga kjo marrveshje ku për këtë vit kanë përfituar 10 fermerë në vlerë 3000 euro mbështetje nga kjo marrveshje bashkfinancimi. Komisioni i ADK së bashku me një anëtar të Drejtorisë BZHRP kanë bërë vlersimin e aplikacioneve dhe kanë bërë përzgjedhjen e përfituesve të kësaj thirrje. Nga ky projekt fermerët kanë përfituar fidane të dredhëzave, sistemin e ujitjës dhe inputet tjera përcjellëse për ngritjen e pemishteve të dredhëzave me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.5 ha.

## **Pagesat Direkte – Subvencione**

Kemi përfundu me sukses fazen e aplikimit për Pagesa Direkte – Subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku kanë aplikuar në këtë thirrje 1265 fermerë të Komunës së Suharekës. Poashtu në këtë faze fermerët të cilët kanë aplikuar për Subvencione kemi bërë pranimin e dëshmive për shpenzimet e kryera (faturave të plehut artificial dhe pranimin e dëshmive për sasinë e grurit të dorëzuar). Si Drejtori kemi pasur volum të shtur të punës, kemi rritur stafin, kemi zgjatur orarin e punës deri në ora 18:00 poashtu edhe të shtunëve dhe të dielave në 2 vikende kemi punuar në mënyrë që të përballojmë fluksin e madhë të fermereve të cilët kanë qenë aplikues të kësaj thirrje të Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

## **Pjesmarrje në puntori të ndryshme**

Kemi pasur takime me organizata të ndryshme edhe vendore edhe ndërkombëtare. Kemi marrur pjesë në puntorinë për trajtimin e qeneve endacak. Takim me Shoqatën e Gjahtarëve “Theranda”. Takim me të gjithë Drejtorët e Bujqësisë në nivel në Ministrinë së Bujqësisë. Vizitë në Rahovec tek Departamenti i Vreshtarisë dhe Verarisë të Ministrisë së Bujqësisë, ku kemi bërë marrveshje për hapjen e 4 rrugëve fushore në Suharekë. Pjesmarrje në tryezën e organizuar nga OSBE në Prevallë. Pjesmarrje në puntorinë e organizuar nga Caritas Zvicëran.

## **Vizita në teren**

Drejtoria e Bujqësisë ka pasur vazhdimisht vizita në teren në shumicën e fshatrave të Komunës së Suharekës. Vizitë në teren në Njëpërbisht, Budakovë, Sallagrazhdë, Samadraxhë, Studençan, Peqan, Leshan, Reshtan, Maqitevë, Sllapuzhan, Mohlan, Suharekë, Gjinoc, Krushicë, Greikoc, Luzhnicë, Javor, Savrovë, Reqan si dhe shumicën e fshatrave të Suharekës, Stafit i Drejtorisë ka bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, në bazë të kërkesave të fermereve që kanë kërkuar në Drejtori. Poashtu stafi i Drejtorisë ka dalë në ternë dhe ka dhënë këshila për fermer dhe udhëzime për subvencione për bujqësi, blegtori.

Stafi i drejtorisë ka dalë në teren ku ka pasur kërkesa për vlerësim të dëmeve dhe ka bërë raporte të detajuar varsisht prej dëmeve që ka hasur në teren.

## **Raporti për Sektorin e Pylltarisë**

Spektori i Pylltarisë si sektor në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari, gjatë 12 muajve vitit 2023 ka vazhduar punën me angazhime maksimal në realizimin e obligimve dhe detyrave me të cilat është i ngarkuar me ligj për mbrojtjen e pyjeve në tërë teritorin e Komunës së Suharekës. Spektori i Pylltarisë ka pranuar 183 kërkesa për damkosje në pyje private. Tekniku i APK-së në pyje private ka damkosur 2819.16m<sup>3</sup> dru zjarri dhe 252.94m<sup>3</sup> dru teknik ku gjithsej ka damkosur 3072.1m<sup>3</sup> dru në pyje private. Tekniku i DBZHRP në Suharekë në pyje private ka vulosur 1703.89m<sup>3</sup> dru zjarri dhe 142.33m<sup>3</sup> dru teknik ku gjithsej ka vulosur 1846.22m<sup>3</sup> në pyje private dhe ka lëshuar 977 fletëpërcjellje për këtë masë drusore për destinacion të caktuar. Janë derguar në gjykatë 76 fletë paraqitje kundervajtëse për 137.13m<sup>3</sup> dru për damtuesit e pyjeve. Janë derguar no gjykatë për vepër penale 12 fletë paraqitje për 31.47m<sup>3</sup> dru për damtuesit e pyjeve ku prej tyre 5 fletëparaqitje janë për uzorpmim të pronës së APK-së. Nga gjykata kanë ardhur 100 aktvendime dhe aktgjykime pozitive për

damtuesit e pyjeve ku 100 damtues janë denuar në vlerë 19150 € ku mesatarja e dënimit për një damtues ka qenë 191.5€, ndërsa janë pezulluar nga gjykata 13 fletparaqitje. Janë konfiskuar 53.88m<sup>3</sup> dru nga damtuesit ilegal.

Në depon grumbulluese në Shirokë kemi 159.78m<sup>3</sup> dru të konfiskuara nga damtuesit ilegal.

Me kërkesen e Policisë kemi bërë 3 vlersime të damëve në pyje private me komision në Maqitevë, Krushicë e Epërme dhe Bukosh. Sektori i Pylltarisë bërë regjistrim të jashtë zakonshëm të damëve pyjore në terrenin pyjor Koka e Ahut-2 për dorzim terreni nga roja e pyllit që e ka lëshuar punën dhe pranimi i terrenit me rojtar të ri i cili është pranuar në mardhënje pune. Me kërkesen e Kryetarit Bali Muharremaj kemi dalur në vendin e ngjarjes dhe kemi bërë damkosjen e 46m<sup>3</sup> të druve të lloit kregëz dhe një pish në parkun e qytetit ku qytetarët janë ankuar te Kryetari i Komunes se këto drunjë në parkë paraqesin rrezik për qytetar sidomos në kohën kur ka erna dhe ekipa e pylltarisë ka bërë damkosjen e druve të cilët duhet te largohen nga parku që paraqesin rrezik për qytetarët. Është bërë regjistrimin e rregullt vjetor të damëve pyjore në të gjitha njesit menagjuese –terenet pyjore që kontrollohen nga rojet e pyllit (regjistrimi i damëve është bërë për secilin teren të rojtarve). Kemi marrë plane operative për mbrojtjen e pyjeve nga damtuesit ilegal në orët e hershme të mengjesit dhe në mbrëmje me përkrahjen e policisë.

Në njesinë menagjuese Rakopeq në vendin e quajtur Stanet e Bukoshit APK-së ka damkosur 433m<sup>3</sup> dru ahu për prerje të cilët dru kanë me u pre gjatë këtij viti.

Në njesinë menagjuese Rakopeq-Delloc në vendin e quajtur Stanet e Bukoshit nga sasia e lartë cekur janë pre 325.35m<sup>3</sup> dru ahu dhe i kanë pre drutë personat që kanë bërë pagesë dhe kanë kontrat për shitblerje me APK-së dhe DBZHRP për prerje dhe marrjen e druve. Në njesin menagjuese Caralev –Biraq APK-së ka damkosur 21m<sup>3</sup> pishë të cilat janë përfshi nga zjarri viteve të kaluara të cilat kanë me u pre gjatë këti viti. Në njesinë menagjuese Caralev-Biraq në paralelen 23/01 nga sasia e lartë cekur janë pre 10.5 m<sup>3</sup> dru pishë .Inxhinjerët e APK-së së bashku me stafin e pylltarisë Suharekë në njesin menagjuese Biraq kanë damkosur përafersisht 90m<sup>3</sup> dru pishë të cilat duhet të rrallohen për shkakë të dendesisë së madhe dhe janë planifikuar të prehen në vitin 2024. Janë bërë rrallimime parakomerciale në sipërfaqe prej 48.5/ha të pyjeve dru bungu në njesin menagjuese në Biraq ku kjo punë është bërë me tender të cilin tender e ka hapur APK-së dhe përcjelljen e punëve të OE e ka bërë Drejtorja Kordinuese e APK-së në Prizren.

**Në vazhdim po paraqes me foto ilustrim disa nga aktivitetet gjashtë mujorin e parë të 2023**



Gjatë shpërndarjes së Mekanizmit Bujqësor. 58 Spërkatëse 400 L për fermerët e Komunës së Suharekës.



Gjatë vizitës në fshatin nëpërbisht tek vëllezërit femer Isa dhe Afrim Hoti, të cilët kanë 1.5 ha me sere si dhe shumë kultura të tjera lavërtare në fuhsë të hapur.



Takimi me Kryetarin e Komunës Bali Muharremaj dhe Komandatin e Policisë në Suharekë Afrim Sylaj me stafin e pylltarisë. Për të rritur kapacitetet dhe angazhimin në mbrojtjen e pyjeve.



Vizitë bletareve në fshatin Papaz.






Gjatë realizimit të projektit “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Bujqësi dhe Pylltari” vranëq



Në fshatin Dvoran tek fermeri Jetmir Aliaj, i cili në fermën e tij ka 15 lop qumshtore dhe 15 vica.



Gjatë vikendit, faza e aplikimit për Pagesa Direkte – Subvencione




Foto nga aktiviteti i Festarit.



Vizitë punimve me zyrtarët e DBZHRP, gjatë ndërtimit të serave.  
Ndërtimi i sistemit të ujitjës për sipërfaqet bujqësore në Mushtisht



Ndërtimi I infrastructures për turizem në bjeshken e Vraniqit



Vizitë fermerëve gjatë mbjelljeve vjeshtore.



Javor, plantacion i arrave



Projekti me bashkëfinancim me PPSE dhe fianishten BES JET në fshatin Nepërbisht

## 6.DREJTORIA PËR URBANIZËM PLANIFIKIM DHE MJEDIS

Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis gjatë vitit 2023 ka vazhduar me angazhime të lartë në realizimin e obligimeve dhe detyrave me të cilat ngarkohet në sektorët e saj. Ky vit veçohet me një angazhim të madh të stafit në klasifikimin, përpunimin dhe mbylljen e lëndëve rreth legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimore. Trajtimin e shumë lëndëve të kategorisë së II për kushte dhe leje ndërtimi është bërë në përputhje me dokumentet planifikuese ku në këtë mënyrë ka vazhduar implementimi i dokumenteve zhvillimore si Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029 dhe Hartës Zonale të Komunës 2022-2030.

Gjashtëmujori i parë i vitit 2023 është karakterizuar me mbylljen e shumë lëndëve të legalizimit të objekteve si dhe me pranimin e një numri të madh të kërkesave për kushte ndërtimore në kuadër të zonës urbane të Komunës. Ndërsa gjashtëmujori i dytë përpos angazhimeve të përditshme që i përkasin drejtorisë

sonë është karakterizuar edhe me menaxhim të projekteve kapitale në fusha të ndryshme urbane. Nga ana e jonë gjithashtu janë bërë përgatitjet për inicimin e procedurave për tenderimin e projekteve kapitale si dhe zbatimin e tyre në teren si: Smart Zona, Rrethojat Urbane, Hapësirat e gjelbëruara sipas PZHK-se, Sistemi i unifikuar i adresave, Sinjalizimi i rrugëve, Largimi i deponive ilegale si dhe Mbikëqyrja e projekteve investive.

Ashtu si në çdo fillim vit edhe në muajt e parë të 2023, DUP ka vazhduar të merret me shqyrtimin e kërkesave të barta nga viti paraprak. Gjithashtu është marr me trajtimin e lëndëve për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimore. Ky proces i filluar qysh nga korriku i 2019 duke vazhduar kështu në 2020, 2021 deri në shtator të 2022 me një rritje të madhe të kërkesave. Vazhdimi i afatit nga MMPHI për legalizimin e objekteve ka ndikuar në shtimin e numrit të kërkesave edhe në këtë vit. Kjo periudhë e fund vitit të 2022 dhe e fillim vitit të 2023 është karakterizuar me lëshimin e një numri të madh të certifikatave mbi legalizimin e objekteve. Procesi i shqyrtimit të lëndëve vazhdon të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Përpos punëve të lartcekura, stafi përgjegjës në DUP është marrë edhe me kryerjen e punëve tjera varësisht nga lloji i kërkesave të palëve, Komunës dhe Institucioneve jashtë saj.

Ky vit po ashtu karakterizohet me numrin e madhe të qytetarëve të cilët i janë drejtuar zyrave të DUPM për tu informuar rreth çështjeve të caktuara e në veçanti sa i përket informatave rreth planeve zhvillimore si dhe rreth aplikimit për kushte ndërtimore duke iu referuar dokumentit të aprovuar të HZK-së.

Gjatë këtij viti janë pranuar **593** lëndë, ndërsa janë përcjellë **1392** shkresa rreth lëndëve të pranuar si dhe të karakterit të ndryshëm. Në vazhdimësi janë mbajtur takime me qytetarë, organizata të ndryshme takime me institucione qendrore si dhe takime të ndryshme në nivel komunal.

Një rendësi e veçantë i është kushtuar takimeve ditore me qytetar apo grupe të caktuara në zyrat e drejtorisë ku janë diskutuar qështje të caktuara në fushën e planifikimit dhe rreth kërkesave të tyre për zhvillime investive si në zonat urbane ashtu dhe në zonat rurale. Takimet rreth zonës urbane kryesisht kanë pasur karakter për investime banimore-afariste ndërsa ato të zonës rurale më shumë rreth investimeve bujqësore. Gjithashtu janë regjistruar edhe disa kërkesa të qytetarëve të cilët kanë ndryshuar mendimin apo kanë shprehur pakënaqësitë për pronat e tyre rreth planifikimit urban me PZHK dhe HZK. Çdo propozim apo ankesë është përfshirë në fletoren e shënimeve nga sektori i planifikimit. Të gjitha këto kërkesa në çdo fund vit do të rishikohen nga Ekipi monitorues dhe në përputhje me dispozitat ligjore me fillimin e procedurës për plotësim ndryshim të planeve, palët do të informohen në mënyrë që të jenë sa më aktiv gjatë fazës së hartimit të planeve të reja.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis vazhdon të bërë maksimumin që punët në drejtori të kryhen me intensitet të shtuar në mënyrë që viti të mbyllet me një sukses pune sa më të lartë.

### DUPM gjatë vitit 2023 është marrë me shqyrtimin e kërkesave të ndryshme.

Deri në fund të vitit janë pranuar **593** kërkesa të ndryshme ku për lëndët që trajton zakonisht drejtoria janë pranuar **556** kërkesa ndërsa për legalizim të ndërtimeve janë pranuar **37** kërkesa. Çdo kërkesë është shqyrtuar në bazë të kapaciteteve njerëzore profesionale që i posedojmë në stafin e DUPM.

#### **Kryesisht kemi pranuar kërkesa për:**

- a. Kushte Ndërtimore
- b. Leje Ndërtimore
- c. Leje rrënimi
- d. Legalizim të objekteve
- e. Shfrytëzim të Hapësirave Publike
- f. Vendosje të Sinjalizimeve rrugore
- g. Emërtim të rrugëve
- h. Pëlqime në parim rreth planifikimeve për investim privat

- i. Përshkrim të planeve zhvillimore dhe rregulluese
- j. Certifikim të objekteve të ndërtuara me leje ndërtimi
- k. Komente rreth HZK-së
- l. Dhe kërkesa të karakterit të ndryshëm.

**Janë përcjell gjithsejtë 1392 shkresa të ndryshme, prej tyre 949 janë shkresa rreth kërkesave të ndryshme si dhe 443 janë rreth legalizimit:**

- a. Aktvendim mbi Kushte Ndërtimore
- b. Njoftime rreth Kushteve ndërtimore,
- c. Aktvendim mbi Leje Ndërtimore,
- d. Leje rrënimi
- e. Njoftime publike
- f. Certifikatë Legalizimi dhe përdorimi
- g. Vendim për përfshirje në listë të pritjes-për legalizim
- h. Vendim për përfundim të punimeve për lëndët e legalizimit
- i. Kërkesë për regjistrim në kadastrës rreth kërkesave të legalizimit
- j. Pëlqime për Shfrytëzim të Hapësirave Publike
- k. Pëlqime në Parim dhe të ndryshme
- l. Përshkrime të parcelave duka u bazuar në Plane Zhvillimore
- m. Plotësim lënde rreth kërkesave të ndryshme,
- n. Raporte,
- o. Ftesa dhe kërkesa
- p. Refuzime të ndryshme,
- q. Njoftime për pagesa të ndryshme

#### **Punë tjera në DUP gjatë vitit 2023:**

- a. Implementimi dhe monitorimi i Harte Zonale të Komunës 2022-2030
- b. Implementimi dhe monitorimi i Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029
- c. Inicimi i procedurave për projekte kapitale që janë nën kompetencën e DUP-së dhe drejtorive të tjera.
- d. Menaxhimi i projekteve kapitale
- e. Raporte të ndryshme për Kryetarin, Drejtorinë e financave, Ministrinë përkatëse dhe auditorët.
- f. Dalje në teren për lëndë të caktuara dhe verifikimi i kërkesave varësisht nga karakteri i tyre.
- g. Inspektimi i objekteve të kategorive të II-ta siç e përcakton ligji për trajtimin e objekteve pa leje.
- h. Vlerësime të ndryshme urbane dhe ndërtimore me kërkesë të palëve apo për nevoja të komunës.
- i. Përcjellja e procesit dhe organizimi i aktiviteteve informuese me grupin punues për legalizimin e objekteve pa leje ne mbështetje nga USAID.
- j. Raportim rreth procesit të legalizimit sipas kërkesës së USAID-it.
- k. Raportim tremujor për Leje ndërtimore sipas kërkesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.
- l. Barazime financiare rreth të hyrave për çdo muaj.
- m. Përcjellja e sistemit të Intranetit si dhe paraqitja e lëndëve të mbyllura.
- n. Futja e të dhënave në sistemin e Përformances Komunale.
- o. Pjesëmarrje në trajnim të ndryshme e stafit te drejtorisë.
- p. Pjesëmarrje e Drejtorit të Drejtorisë në Asociacionin e komunave të Kosovës.

Në vazhdim të këtij raporti do të përshkruhen zhvillimet dhe arritjet në forma tabelore në nivel të drejtorisë të krahasuara me vitet paraprake.

Në tabelë është prezantuar protokollin hyrës dhe dalës i lëndëve në DUP për 14 vite

Nr .	Viti	Protokolli i pranimit	Protokolli i dërgimit	Protokolli për legalizim pranim	Protokolli për legalizim dërgim
1.	2010	478	762	/	
2.	2011	572	1063	/	
3.	2012	594	1083	/	
4.	2013	580	969	/	
5.	2014	662	1039	/	
6.	2015	687	1105	/	
7.	2016	713	1132	/	
8.	2017	826	1239	/	
9.	2018	525	998	/	
10.	2019	448	807	54	69
11.	2020	333	560	139	363
12.	2021	367	682	174	369
13.	2022	428	840	456	679
14.	<b>2023</b>	<b>556</b>	<b>949</b>	<b>37</b>	<b>443</b>

Tabela 1: Lëndët hyrëse dhe dalëse për 14 vite

Sa i përket lëndëve prej **556** kërkesave të pranuar në këtë vit, gjithsejtë deri në momentin e raportimit janë mbyllur **456** kërkesa ndërsa janë në proces **100** kërkesa. Sa i përket legalizimit janë pranuar **37** aplikime.

Në këtë vit janë certifikuar **83** kërkesa ndërsa **105** janë në proces duke përfshirë edhe vitet paraprake. Sa i përket procesit të legalizimit gjithsejtë nga 2019 deri në fund të vitit 2023 janë pranuar **862** kërkesa ndërsa janë lëshuar gjithsejtë **1926** dërgesa.

#### **Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje rrënimi:**

Sektori i urbanizmit është marrë kryesisht me shqyrtimin e kërkesave të tilla. Kërkesat janë shqyrtuar nga stafi profesional i drejtorisë dhe vendimet janë marrë duke u bazuar në Dokumentet e planifikimit, Ligjet në fuqi dhe Normat teknike të planifikimit hapësinor.

Në tabelle janë prezantuar kërkesat rreth Kushteve ndërtimore, Leje Ndërtimi dhe Rrënim për një vit

Lloji i kërkesës	Totali i pranuar	Të aprovuara	Të refuzuara	Te pezulluara	Në proces
Leje ndërtimi	74	62	-	1 (terhjeqje)	11
Kushte ndërtimore	95	61+ (1 njoftim rreth kërkesës)	19	3 (terhjeqje)	11
Leje rrënimi	17	15	2	-	-
Certifikata Përdorimi	4	4	-		
Prani Total	556	-	-	-	
Dërgim Total	949	Te mbyllura ne total 456	-	-	Ne proces 98

Tabela 2: Shqyrtimi i kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje Ndërtimi dhe Leje Rrënimi

130 MALLRA DHE SHËRBIME	43,240.00	33,772.63	9,467.37	78%
132 SHPENZIME KOMUNALE	1,313.69	1,313.69	0.00	100%
<b>94532 GJIMNAZI - JETA E RE - SUHAREKE</b>	<b>534,885.01</b>	<b>534,587.21</b>	<b>297.80</b>	<b>100%</b>
111 PAGA DHE SHTESA	472,535.33	472,535.33	0.00	100%
130 MALLRA DHE SHËRBIME	55,140.00	54,842.20	297.80	99%

132 SHPENZIME KOMUNALE	7,209.68	7,209.68	0.00		100%
<b>94533 SHKOLLA E MESME E LARTEPROFESIONALE SHIROKE</b>	<b>435,794.41</b>	<b>507,677.95</b>	<b>-71,883.54</b>		<b>116%</b>
111 PAGA DHE SHITESA	382,515.40	467,784.99	-85,269.59		122%
130 MALLRA DHE SHËRBIME	49,751.00	36,364.95	13,386.05		73%
132 SHPENZIME KOMUNALE	3,528.01	3,528.01	0.00		100%
<b>21 TE HYRAT VETANAKE</b>	<b>20,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>20,267.00</b>		<b>0%</b>
<b>94530 ARSIMI I MESEM - SUHAREKË</b>	<b>20,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>20,000.00</b>		<b>0%</b>
132 SHPENZIME KOMUNALE	20,000.00	0.00	20,000.00		0%
<b>Totali i përgjithshëm</b>	<b>1,848,436.32</b>	<b>1,835,318.41</b>	<b>12,850.91</b>		<b>99%</b>

INVESTIMET KAPITALET PËR VITIN 2023-ARSIMI					Situacionet e paguara				Shuma e shpenzimeve per projekte	Mbetjet nga projektet 2 vjeqar	% e shpenzuar e buxhetit		
nr.	kodet	ARSIMI DHE SHKENCA	fondi (10)	fondi (211)	kontratat	I	II	III					IV
1	52091	Ndërtimi i sallës sportive shfmu "Dëshmoret e Greikocit" Greikoc	50,000.00							-	-	100%	
2	52092	Ndërtimi i sallës sportive në shmt"Skender Luarasi"- Suharekë	50,000.00							-	-	100%	
3	52904	Ndërtimi i sallës sportive shfmu GK.K.Skenderbeu"- Salagrazhde	150,000.00		267,648.92	50,000.00	50,000.00	50,000.00	-	150,000.00	117,648.92	56%	
4	52328	Ndërtimi i sallës sportive shfmu"Naum Veqilharxhi" Mohlan	150,000.00		279,999.97	45,000.00	35,018.50	69,981.50	20,000.00	170,000.00	109,999.97	61%	
5	52394	Ndërtimi i sallës sportive shfmu"Shaban Mazreku" Sopjje	45,000.00		268,480.52	45,000.00	50,000.00	-	-	95,000.00	173,480.52	35%	
6	52396	Ndërtimi i aneksit te objekti SHFMU "Besim Ndrecaj".Maqitëve	101,092.00		251,746.50	20,094.00	-	-	-	20,094.00	231,652.50	8%	
		Meremetimi i shkollës "SadriDuhla" ne Laxhen Sopaj	18,908.00		18,908.00	10,000.00	3,397.00	5,511.00	-	-	18,908.00	-	100%
		Rednovimi i shkollave 7 MarsiRamë Bllaca	20,000.00		20,000.00	6,365.60	10,122.30	3,512.10	-	20,000.00	-	100%	mjetet nga MSH
		Punimi i utesjellsit ne SHFMU"Dëshmoret e Kombit"-Vraniq	5,977.81		5,977.81	5,977.81	-	-	-	5,977.81	-	100%	mjetet nga MSH
		<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>590,977.81</b>							<b>479,979.81</b>	<b>632,781.91</b>		

- Drejtoria Komunale e Arsimit për vitin shkollor 2023/2024 ka shpallur konkursin për bursa në të cilin kanë aplikuar gjithsej 662 kandidatë prej të

cilëve janë ndarë gjithsej 420 bursa, 270 bursa për student dhe 150 bursa për nxënës

### **Konkurset**

Në mbështetje të UA nr.151/2020 dhe UA nr.05/2021 dhe UA nr.05/2015– të MASHT-it për pranimin e kuadrit arsimor, janë shpallur:

➤ Tetë (8) konkurse për drejtor shkolle :

-Konkursi për drejtor SHFMU "Ramë Bllaca" në Bllacë (rishpallje) për të cilin është përfunduar procedura.

- Konkursi për drejtor në SHFMU "Bajram Curri" në Nishor është rishpallur dy here-proceduar është përfunduar

-Konkursi për drejtor në SHFMU "Flamuri i Arbërit" në Reshtan (është anuluar tri here për shkak të mungesës së aplikuesve).

-Konkursi për drejtor shkolle në SHFMU "Xhavit Sylaj" në Sllapuzhan është anuluar në mungesë të numrit të aplikuesve.

-Konkursi për drejtor në SHFMU "Migjeni në Gjinoc është anuluar në mungesë të numrit të aplikuesve

➤ Një konkurs për sekretar shkolle ( i cili është rishpallur për të dytën here dhe tani është në procedurë)

Shtatë konkurse për nëpunës mbështetës dhe teknik( prej tyre dy janë rishpallur ) dhe të gjitha janë përfunduar me sukses

➤ Pesë (5) konkurse për mësues, edukatore etj.

➤ **Tre (3) konkurse për psikolog :**

-Një psikolog në IP "Fluturat" -Suharekë

-Një psikolog në SHFMU "Sadri Duhla" në Duhël

-Një psikolog në SHFMU "7 Marsi" në Suharekë ( është rishpallur dhe përfunduar me sukses)

➤ **Një (1) konkurs për asistent për FNV-gjithsej 7 pozita të lira**

➤ **Pensionime:** gjatë kësaj periudhe janë pensionuar gjithsej shtatëmbëdhjetë (36) punëtor

➤ **Pushime të lehonisë :** gjatë kësaj periudhe në pushim të lehonisë kanë qenë tridhjetë shtatë

**(37) punëtorë.**

Ne vitin 2023 nuk është shpallur asnjë konkurs plotësues.

Furnizimi i nxënësve me tekste

Duke u bazuar nga informatat e shkollave nxënësit në klasat 1-5 janë të pajisura me tekste shkollore, ndërsa klasat 6-9 mbi 70% janë pajisur me libra të vjetra. Vazhdon procedura e pajisjes së nxënësve me tekste shkollore.

#### Takime të rëndësishme të DKA-së

- Takimet e rregullta javore konsultative të drejtorëve komunal me Kryetarin e Komunës.
  - Takime pune me inspektorët e arsimit të SIA-së në Prizren
  - Takimet zyrtare në MASHT
  - Takime me SIA
- Takimet në asamblenë komunale

Takimet javore me stafin e DKA-së

Takimet mujore me drejtorët e shkollave.

Takime të ndryshme me organizata dhe donatorë për realizimin e projekteve për ngritjen e cilësisë së arsimit.

Objektivat për periudhën e ardhshme

Ngritja e suksesit të nxënësve për periudhën e ardhshme dhe zvogëlimi i numrit të mungesave

-Shpallja e konkursit dhe pranimi i kuadrit në bazë të normativit për pranim të kuadrit.

Organizimi dhe mbajtja e vlerësimeve brendshme dhe të jashtme të njohurive të nxënësve

Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore në kuadër të shkollave.

Pajisja e shkollave me mjete mësimor.

Rregullimi dhe meremetimi i objekteve shkollore me prioritet.

Vizitë- monitorim dhe kontroll sipas planifikimit dhe nevojat e shkollave.

## 9.DREJTORIA PËR KULTURË RINI SPORT DHE MËRGATË

Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë gjatë këtij viti ka realizuar aktivitetet e më poshtme të ndara në bazë të sektorëve. Poashtu vlen të theksohen vështirësit e shfaqura në realizimin e detyrave dhe obligimeve të drejtorisë tonë. DKRSM-ja ka bërë takime punë me Drejtor të Drejtorive përkatëse të komunave fqinje, me të cilat shkëmbyem idet dhe përvojat tona për një menaxhim më të sukseshëm. Gjatë këtij viti janë mbajtur takime me kolegjin e Drejtorëve të DKRS me iniciative nga Asociacioni Komunave. Janë mbajtur takimet për performancë vazhdimisht, duke shqyrtuar raportin e vitit të fundit si dhe duke punuar për një raport për performancë më të mirë për këtë vit. Në fillim të këtij viti janë shpërndarë mirënjohje nga Lidhja Rajonale e Futbollit – Prizren, për sportistët e Komunës sonë. Nënshkrimi i Kontratës Sociale me USAID, ku programi artistik dhe koktejt u organizua nga DKRSM. Rregullimi i nyjeve sanitare në bibliotekë, muze dhe në palestër. Është bërë pranimi i kërkesave,

ankesave, njoftimeve, faturave dhe shqyrtimi i tyre. Takime me OJQ, klube sportive e qytetarë janë mbajtur pothuajse çdo ditë. Është përfunduar raporti përfundimtar i OJQ-ve për vitin 2022, i kërkuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit. Vizita nga Ambasadorja Nancy Soderberg, Drejtoreshë e NDI, ku në atë takim u diskutua mbi avancimin e barazisë gjinore dhe integrimin e qasjes gjithëpërfshirëse në politikbërje dhe në vendimmarrje. Si rezultat i këtij takimi u formua një mekanizëm për çështjet e lartpërmendura, ku pjesë e këtij mekanizmi edhe DKRSM do të ketë përfaqësuesit e saj. Vendosja e solarëve në Bibliotekën e qytetit “Hajdin Berish” nga UNDP. Puntori me Un Women Kosova, për buxhetimin gjinor. Vizitë në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stuttgart, ku aty takuam Udhëheqësen e Konsullatës znj. Lumturie Lipoveci dhe me Konsullin Gramoz Berisha. Gjatë këtij takimi diskutuam për vështësitë e Shoqatave Kulturore dhe të rinjët kosovarë që jetojnë në Stuttgart dhe për ofrimin e kushteve dhe mundësive për të zhvilluar aktivitetet në gjuhën shqipe. Furnizimi me libra shqip në Bibliotekën e qytetit të Fellbach në Gjermani. Në Bibliotekë u pritëm nga znj. Solveig Scheider, Udhëheqëse e Bibliotekës, së cilës dhe ja dhuruam kontingjentin me libra. Festimi i Ditës së Nënës në Fellbach të Gjermanisë, me grat shqiptare, që jetojnë dhe punojnë atje. Takime të vazhdueshme me USAID-Kosovën në kuadër të Kontratës Sociale, për projektin “Trajnim për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara”. Është punuar për plotësim-ndryshimin në rregulloren për subvencione, në pjesën e DKRSM-së. Takime të vazhdueshme me ojq-të dhe klubet sportive. Përrurimi i qendrës rekreative për persona me Sindromën Down dhe Autizëm “Duje”. Përrurimi i këndit të leximit për fëmijë dhe këndit për persona me aftësi të kufizuara në Bibliotekën e Qytetit “Hajdin Berisha”. Vizita e ish kryetarit të komunës së Fellbach-ut z. Christof Palm, dhe organizimi i ceremonisë së nënshkrimit ku ky i fundit u shpall Qytetar Nderi i Komunës së Suharekës. Janë mbajtur takime të vazhdueshme për organizimin e Karnevaleve Golden Eagle, Festivalit të Kulturës dhe Verës “Fetari 2023”, Diafestit.

## **Sektori i Kulturës**

Gjatë këtij viti, sektori i kulturës ka zhvilluar aktivitete të ndryshme. Me 15 Shkurt u shënua dita e Flamurti Ashkali, ku kjo festë u mbështet nga DKRSM-ja me një program kulturor-edukativ i mbajtur nga fëmijët e këtij komuniteti si dhe një darkë ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga komuniteti ashkali dhe përfaqësues nga institucionet e komunës etj. 17 Shkurti “Dita e Pavarësisë së Kosovës” këtë vit u shënua me anë të homazheve dhe dekormit të qytetit dhe lapidareve me flamuj. Dita e Gruas u shënua me një tavolinë diskutimi e mbështetura edhe nga OSCE, me temën “Qasja e barabartë në pronë dhe drejta të trashëgimisë për gratë dhe burrat në komunën e Suharekës”. Vizita e profesorëve dhe studentëve të artit nga New York dhe punëtorja një javore me të rinjët e Komunës së Suharekës ku u zhvilluan aftësitë për animacion video, produksion dhe art interaktiv. Ekspozita të ndryshme personale nga artistët tanë. Akademi përkujtimore për dëshmorët Milazim Kiqina dhe Enver Bytyqi, ku gjatë kësaj akademie u promovua edhe libri kushtuar dëshmorit Milazim Kiqina, me autor Beqar Kiqina. Homazhe për nder të dëshmorëve, në data të rëndësishme të secilit prej tyre. Vizitë në bashkinë e Kavajës për nder të ditës së rëndësishme Dëshmor të Indrit Carës. Organizimi i javës së pastrimit me pjesëmarrës nga të gjitha fushat, kultura, sporti, rinia dhe përfaqësues të ndryshëm nga shoqëria civile. Promovimi i katalogut për arkeologji në Suharekë, katalog ky i financuar nga DKRSM-ja. Hapja e ekspozitës nga Kunstvereid Fellbach, ku pjesë e kësaj ekspozite me punime e tyre ishin edhe piktorët nga Suhareka, Refki Gollopeni, Bardhyl Bejtullahu, Fatos Kabashi, Liridon Gashi. Organizimi i festës “FC Ballkani – Kampion”. U mbajt Pranvera Poetike edhe këtë vit. Krijues nga të gjitha trojet shqiptare u bashkuan në qytetin e Suharekës për të prezantuar krijimet e tyre. Manifestim i Ditës së Clirimit dhe Ditës së Dëshmorëve në Suharekë. Dita e 13 Qershorit ka filluar me homazhe tek

parku i Dëshmorëve, pastaj ka vazhduar me akademin përkujtimore në bibliotekën e qytetit, ku edhe u ndan cmimet dhe dekoratat për nder të dies së 13 Qershorit. Në Muzeun e qytetit është bërë pranim-dorëzimi i Vendimit të bashkimit të dy njësive të UCK-së, “Qeliku 50” dhe “Lisi” në një komandë. Më tutje dita ka vazhduar me zbulimin e gurit dhe pllakës së këtij Vendimi në fashatin Studencan, ku edhe është nënshkruar ky Vendim. Marshi i Veteranëve të UCK-së edhe këtë vit u realizua në pjesëmarrje masive. Dita u përmyll me koncertin festiv për 13 Qershor në sheshin e qytetit. Promovimi i librit “Këngët e Shekullit Kallkan” nga autorja Ilirjana Baraliu-Lladrovci. Homazhe për nderë të dëshmorëve, në data e rënjes të secilit prej tyre.

Organizimi i “Diafestit” për 4 netë me radhë, ku dy netët e para ishin Hiking me të rinjët e qytetit tonë dhe me të rinjët nga diaspora, dhe dy netët e fundit kishte organizim të koncertit për të rinjë dhe me muzikë popullore. Promovimi i dy librave “Plaku dhe nipi” dhe “Mendoj për ty” nga autori Ramadan Reshitaj, bashkëatdhetar nga Suedia. Festivali i Kulturës dhe Verës - Festari 2023, Dita e parë / 18.09.2023 1. Ekspozitë me motive tradicionale shqiptare nga autori Shpend Kada - “Nama”; 2. Mbrëmje muzikore nga Beska Band. Festivali i Kulturës dhe Verës - Festari 2023, Dita e dytë / 19.09.2023 1. Dhurimi i gjakut; 2. Dhurimi i librave; 3. Dhurimi i veshmbathjeve; 4. Punëtori arti me Handikos Suhareke dhe nxënësit e shkollave të mesme; 5. Festari poetic; 6. Shfaqje teatrale; 7. Karaoke night. Festivali i Kulturës dhe Verës - Festari 2023, Dita e tretë / 20.09.2023 1. Aktivitete sportive nga personat me aftësi të kufizuara; 2. Revyja e rapsodëve “Rizah Bllaca”.

Festivali i Kulturës dhe Verës - Festari 2023, Dita e katërt / 21.09.2023 1. Festari shkollor; 2. Festari i fëmijëve; 2. Mbrëmje e muzikës popullore nga viset shqiptare.

Festivali i Kulturës dhe Verës - Festari 2023, Dita e katërt / 22.09.2023 1. Parakalimi Komunë - SHFMU “7 Marsi”; 2. Ekspozita e prodhimeve bujqësore; 3. Lojëra popullore / tërheqje litari, hedhje guri, shigjetari, gjuajtje me pushkë ajrore; 4. Rock Festari.

Festivali i Kulturës dhe Verës - Festari 2023, Dita e gjashtë / 23.09.2023 1. Paragliding Festari Suhareka Open 2023; 2. Kputja e kalaveshit të rrushit; 3. Hapja e ekspozitës së Kolonisë Artistike; 4. Gala mbrëmje.

Në përkujtim të ish Kryetarit të Komunës “Ukë Bytyqi”, është mbajtur akademi solemne.

Me çmimin “Ukë Bytyçi”, për udhëheqje të mirë u nderua biznesmeni Mefail Gashi.

Në mbështetje të DKRSM është organizuar:

Java e Filmit në Suharekë

Festivali për fëmijë “FËMIJËT NË SKENË” (Edicioni i pesëmbëdhjetë)

U promovua libri “Prush kujtimesh”, i autorit Refki Reshitaj dhe organizimi i mbrëmjeve muzikore për nderë të Festave të Fundvitit. Numri i përgjithshëm nëpër të gjitha aktivitetet kulturore rreth 20.000

## **Spektori i Sportit**

Me 26 Shkurt në qytetin e Istogut është mbajtur Kampionati i tretë i Kosovës në Lojën me Kapuçë e organizuar nga Klubi Alpin Podguri, nën patronatin e Federatës së Lojrave dhe Sporteve Tradicionale të Kosovës. Pjesëmarrës nga komuna e Suharekës ishin 5 persona të moshës së shtyer së bashku me shoqatën për trashëgimi kulturore “Plisi”. DKRSM-ja i ka mbështetur duke i siguruar transportin.

Shoqata “Sporti Shkollor” e cila mbështetet nga DKRSM-ja ka mbajtur garat komunale në basketboll për shkollat fillore dhe të mesme.

Shoqata “Sporti Shkollor” gjithashtu ka organizuar garat regjionale ne basketboll për regjionin e Prizrenit për shkollat fillore dhe të mesme, në të dyjat kategorit.

Shpallja kampion e FC Ballkanit dhe organizimi i ndeshjes së fundit.

Dita Olimpikë në Suharekë u shënua me qindra nxënës dhe fëmijë të qytetit tonë.

Është mbajtur turniri në futboll të vogël tashmë tradicional në fshatin Sopijë “Sadik Ramadanaj” Ky turnir zgjati 21 netë me radhë ku ekipe pjesëmarrëse ishin 64 nga qytete të ndryshme të Kosovës dhe një nga ekipet ishte “KF BESA” –Sllupçan nga Komanova po ashtu është mbajtur turniri tjetër tradicional në volejboll “Genc Zyba”.Ky turnir zgjati 5 netë, ku ekipe pjesëmarrëse ishin 16.

Gara e MX RACE në kategorinë Mx1, Mx2 dhe Mx3 u mbajt dhe u organizua nga Theranda Motorcross.

OFF ROAD kanë organizuar garën në 4x4 Race edicioni 2 OFF ROAD THERANDA

Pjesëmarrja e të rinjve në aktivitete sportive gjatë tërë vitit ishte rreth -22.000

### **Sektori i Rinisë**

Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime ka mbajtur trajnimin e radhës në Komunën e Suharekës. Këto trajnime kanë qenë me focus të veçant për orjentim në karrierë për treg adekuat të punës, këshillim për krijimin e profilit profesional dhe trajnime për shkathtësi punësimi dhe të sipërmarrjes, në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve të të rinjve permes trajnimeve profesionale dhe orjentimit në karrierë”. Democracy for Development ka mbajtur sallonin e diskutimit në Komunën e Suharekës, me temën “Ngritja e kapaciteteve tek të rinjët e Suharekës – sa janë aktivë në proceset e avokimit”. Kuvendi Rinor i Suharekës ka pasur shumë organizime gjatë këtij viti gjithashtu ishin pjesë e çdo aktiviteti të DKRSM. Të njëjtit kanë bërë edhe një aktivitet në Qendrën Rekreative për persona me Sindromën Down dhe Autizëm “DUJE”, ku bënë dhurata për fëmijët e kësaj qendre. Gjate organizmit të ditëve të diasporës Kuvendi Rinor ka organizuar kampingun veror në malet e Dollocit. Po ashtu kane marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e Festarit dhe kanë qenë pjesëmarrës në paradën e organizuar nga Unioni i Bashkive Shqiptare duke përfaqësuar Komunën e Suharekës. Numri i përgjithshëm në të gjitha aktivitetet rinore gjatë tërë vitit ka qenë rreth 5000 .

### **Sektori i Mërgatës**

Janë mbajtur takimet me kolegjiunin e Diasporës nga MPJD, ku edhe u diskutua për organizimet që do të bëhen për nderë të diasporës.

Ditët e Diasporës janë mbajtur me aktivitete të shumta kulturore, artisitke dhe rekreative.

### **Biblioteka**

#### **RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2023 NË BIBLIOTEKË “ HAJDIN BERISHA”**

- **RAPORTI STATISTIKOR I VITIT 2023**

Gjatë këtij viti nga Janari e deri në fund të Dhjetorit numri i lexuesve arriti në 1041, libra te lexuara janë 6865. Në sektorin e fëmijëve të regjistruar janë 651. Ndërrimi i librave është 4064, kurse në sektorin e të rriturve të regjisrtuar janë 390, ndërrimi i librave është 2801.

Ndërsa 2668 është numri i lexuesve që i kanë shfrytëzuar sallat e leximit.

Me pagesë janë regjistruar 823 lexues, vlera në para 2057.50cent.

Të liruar nga pagesa 218 lexues.

-Biblioteka është pasuruar me libra te reja gjithsej 1258 si dhe ne gjuhen serbe 42 dhe alfabetin e Braille 16 egzemplar.

#### • **RAPORTI I PËRPUNIMIT TË LIBRIT DHE I SHËRBIMIT**

- Është punuar në përgatitjen e planeve zhvillimore, vjetore dhe përgatitja e raporteve për rezultatet e punës dhe ecurinë e shërbimeve.

- Përgjegjësia për menaxhimin financiar të Bibliotekës për sasinë e mjeteve materiale të participimit.

- Është punuar në përpunimin e librave të blera dhe të dhuruara, signaturat e librave sipas KUD-it dhe regjistrimi I librave në libër të inventarit.

- Puna me lexues ndërrimin e librave, konsultime dhe njoftime me lexuesit.

- Ofrimi i shërbimeve informues orientus dhe relativ për të gjetur informacionin e kërkuar nga biblioteka.

- Mbikëqyrja e aktivitetit në bibliotekë

- Kujdesi për libra të humbur dhe plotësimin e tyre.

- Është punuar Lista e përzgjedhjes së librave për blerje nga MKRS

#### • **BASHKËPUNIMI ME BIBLIOTEKA**

- Është bashkëpunuar me bibliotekat shkollore me Bibliotekën ndër komunale në Prizren dhe Bibliotekën Kombëtare.

-Në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë në mes bibliotekës së qytetit me bibliotekën regjionale të Prizrenit, është mbajtur kursi i gjuhes angleze për bibliotekat në bibliotekën e Prizrenit gjegjësisht në këndin amerikan.

- Biblioteka ka bashkëpunuar edhe me SHAK “Elena Gjika”, ku gjatë këti viti ka organizuar konkurs letrar aktivite të tjera.

#### **AKTIVITETET NË BIBLIOTEKË**

- Mbikqyrja e aktiviteve të cilat u zhvilluan gjatë këtij viti

- Janë mbajtur disa aktivite ne Bibliotekë si:



Akademi perkujtimore, mbledhje komemorative, vizita të nxënësve te shkollave të ndryshme.  
Në kuadër të vizitave shkollore, Bibliotekën e vizituan disa shkolla fillore dhe të mesme të vendit:

SH.F.M.U “LIRIA” –Savrovë, nxënësit e klasës së III-të dhe klasës së V-të

SH.F.M.U “RAMË BLLACA”- Bllacë ,nxënësit së IV-të

SH.M.P “ AVDYL RAMA”- Shirokë, nxënësit e klasave të XII-të

Me 24.11.2023 SHAK “Elena Gjika-Dora d’istria” për nder të festës së flamurit është mbajtur ora letrare, si dhe promovimi i librit Brerore Lirie numër 15.

Në Bibliotekë u mbajtën edhe akademi perkujtimore nën patronatin e kryetarit te Komunës  
z. Bali Muharremi

- **INVESTIMET NË BIBLIOTEKË**

-Këtë vit me 27.02.2023 Biblioteka e Qytetit “Hajdin Berisha”, si dhe Ministria për Kulturë Rini dhe Sport, kemi lidhur Memorandum Bashkëpunimi.

Ministria për Kulturë Rini dhe Sport merr përsipër obligimet e Memorandumit të Bashkëpunimit si në vijim: Ofron mbështetje financiare në vlerë prej 6,451 ( gjashtëmijë e katërqind e pesëdhjetë e një euro), pjesë e marrveshjes ka qen që 5% e buxhetit të shfrytëzohet për blerjen e librave për komunitete të cilët jetojnë në Kosovë. Dhe të paktën 5% e buxhetit të shpenzohen për blerje të librave në alfabetin e Braille. Marrëveshja u respektu dhe u realizuan blerjet e librave. -Në kuadër të Projektit “Fuqizimi I veprimit lokal për klimen” është bërë instalimi si dhe inaugurimi I sistemit solar në Bibliotekën e Qytetit, investim ky nga UNDP Ambasada Austriake dhe Komuna.- Në Bibliotekë është krijuar edhe një kënd i fëmijëve , ku pikërisht në ditën ndërkombëtare të fëmijëve është përruruar këndi I cili do të shërbejë si ambient i ngrohtë dhe shumë-ngjyrësh për fëmijët.

***-Të bashkangjitur keni numrina total***

***Numëri i lexuesve në këndin e fëmijëve, 4064***

***Numëri i lexuesve në këndin e të rriturve, 2801***

***Numëri i lexuesve në sallë, 2668***

***Raporti mbi te hyrat fnanciare nga regjistrimet është 2057.5€***

## Muzeu

Gjatë këtij viti janë mbajtur takime me Asociacionin e Komunave me fokus të trashëgimisë kulturore dhe monumenteve kulturore.

Vizitorët në muze gjatë kësaj periudhe nuk janë të shumtë në numër, por interesimi për vizitat në muze nuk ndalen. Vizitorët më të shpesht janë fëmijët e shkollave fillore dhe atyre të mesme, gjithashtu edhe studiuesit të cilët kanë nevojë për informata shtesë sa i përket trashëgimis kulturore të qytetit tonë. Shkollat fillore kanë vazhduar me vizitat në Muzeun e qytetit në kuadër të Ditës së Clirimit dhe Ditës së Dëshmorëve.

## Palestra Sportive “13 Qershori”

Gjatë periudhës raportuese në Palestrën Sportive “13 Qershori” janë zhvilluar shumë aktivitete sportive ku përfshihen seanca stërvitore për klubet dhe lojë. Klubet të cilat zhvillojnë aktivitet në palestër janë: KB “Ylli”, U-12, U-16, U-18; Studenqani, KB “Theranda”, KV “Gjinoci”, KV “Theranda”, KB “Tirana”, KB “Theranda”, “Qeliku”, “Puma”, KB “Prizreni”. Të bashkangjitura në këtë raport do të gjeni edhe disa fotografi të aktiviteteve të Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, gjatë tërë vitit 2023.

Subvencione janë shpenzuar 297.300 euro

Të bashkangjitur gjeni listat përfituese nga thirrjet publike të ofruara nga DKRSM

## Lista përfituese nga thirrja e parë:

	Përfituesi	Titulli i projektit	Shuma
1	10-181-03-0037679/23 Fuqizimi i gruas dhe rinis Suharekë	Fuqizimi i të rinjëve përmes pjesmarrjës në aktivitete kulturore	2500€
2	10-181-03-0038332/23 SHOQATA ART FEST	Promovimi online i turizmit dhe kultures së Therandës përmes krijimit të platformës digjitale Inside Theranda	3000€
3	10-181-03-0038294/23 Klubi i Tenisit Suharekë	Masovizimi i sportit të Tenisit në Suharekë	2000€
4	10-181-03-0038292/23 Klubi Teakwondo Hapkidopuma	Gara kombëtare e ndërkombëtare	2000€
5	10-181-03-0038291/23 Kb “Goldean Eagle Ylli “	KBYlli -Kampion	I ka refuzuar (2000)
6	10-181-03-0038285/23 Ndërto shoqëri pa injorancë	Të rinjët dhe aftësia e të folurit në publik	4200€
7	10-181-03-0038279/23 OJQ”ARIA”	Kocert Veror, Diafesti, Festari i Festari i fëmijëve dhe Koncerti i fundvitit	9800€

8	10-181-03-0038246/23 Shoqata e zhvillimit të shoqërisë	Edukim jo-formal mbi vullnetarizmin dhe angazhimin e të rinjëve	1359
9	10-181-03-0038243/23 Shkolla e futbollit Suhareka	Zhvillimi i kampionatit 2022/2023 në kuader të Federatës së Kosovës në Futboll, dhe pjesmarrja në turnirin mbarkombëtarë Ulpiana Cup 2023	3500€
10	10-181-03-0038196/23 Off road Theranda	Organizimi i garave mbarkombëtare në kuadër të Festari 2023	4000
11	<b>10-181-03-0038160/23</b> <b>KV "THERANDA "MESHKUJT</b>	Zhvillimi i sportit elitare, garues dhe ngritja e kapaciteteve për arritjen e rezultateve sportive	15000€
12	10-181-03-0038155/23 KV "THERANDA" FEMRAT	Avansimi dhe masovizimi i sportit të Volejbollit dhe Beach-Volleyit	7000€
13	10-181/03-0038104/23 OJQ "ALTERNATIVA PËR INTEGRIM"	Edukimi dhe parandalimi i fenomeneve negative tek të rinjtë	1500€
14	10-181-03-0038066/23 OJQ "MOREA"	Stop substancave të dëmshme-Rinia e shëndoshë	2500€
15	10-181-03-0037970/23 OJQ"ELITA"	Përkrahja e të rinjëve për një jetë të shëndetshme si dhe parandalimi i dhunës psikike dhe fizike	2000€
16	10-191-03-0037829/23 KUVENDI RINOR I SUHAREKES	Youth 4 Youth	11000€
17	10-181-03-0037941/23 SHKOLLA E BASKETBOLLIT" THERANDA BASKET"	Sporti Shkollor Basketbolli	2000€

18	10-181-03-0037788/23 Shoqata e Zjarrefikësve Vullnetar të Shpëtimit	Vetëdijësimi i nxënësve në shkolla për përandalimin e zjarreve fushore dhe malore	I ka Refuzuar (2500€)
19	10-181-03-0037148/23 GAM THERANDA	Programe muzikore –Suhareka 2023	19000€
20	10-181-03-0035878/23 ELENA GJIKA DORA D`ISTRIA	Aktivitet vjetor të Shoqatës për art dhe kulturë Elena Gjika Dora d'Istria në Suharekë	5000€
21	10-181-03-0036692/23 SHOQATA SPORTI SHKOLLOR	Organizimi i garave shkollore ne nivel komunal për SHFMU dhe SHML në Suharekë	2000€
22	10-016-01003719/23 Klubi Atletikë Theranda 1992	Mosovizimi i AtletikësModerne si Mbretëreshë e Sportit, Organizimi i Garave Tradicionale Pupullore	4000€
23	10-181/03-0037464/23 Klubi i Karates “Çeliku”	Zhvillimi i kampionatit 2022/2023 në kuadër te Federatës të Karates së Kosovës	2000€
24	10-181-03-0037604/23 Instituti për vetëdijësim bashkëkohor	Festivali i Teatrove Suharekë	2000€
25	10-181-03-0037609/23 Klubi Triathlon Suhareka	Masovizimi i sportit të triathlonit si sport olimpik tek rinjët	2000€
26	10-181-03-0037676/23 OJQ IKAT HISARI	Ndërgjegjësimi i të rinjëve mbi trashëgimin kulturore	1500€
27	10-181-03-0037656/23 OJQ”HANDIKOS”	Me sportin jemi më të fort	3760€
28	10-181-03-0037737/23 Avancimi i pozitës së komuniteteve	Të rinjët, vullnetarizmi pengimi i dukurive negative tek te rinjët	1000€
29	10-181-03-0038167/23 Ojq DUA	Java e Filmit në Suharekë	8000€
30	10-181-03-0038326/23 Giss software solution	Promovimi i turizmit në Komuen e Suharekës	2000€

31	10-181-03-0038345/23 Blerim Kabashi	Krijimi i kushteve për ngjarje kulturore sportive	1000€
32	10-181-03-0038344/23 Meriton Kabashi	Promovimi i sportit për të rinjë	1000€
33	10-181-03-0038342/23 Refki Reshitaj	Botimi i librit autorial me poezi	800€
34	10-181-03-0038340/23 Fatlum Jashari	Turniri tradicional në futboll të vogël	1000€
35	10-181-03-0038337/23 Leonita NRECAJ	Aktivitete Muzikore	600€
36	10-181-03-0038349/23 Drenushë Morina –Gashi	Të rinjët hulumtues	1000€
37	10-18-03-0038299/23 Ardita Hjadari	Rini e shënoshë-Ushqimi i Shëndetshëm	970€
38	10-463-020038249/23 Shkëlzen Avdyli	Ikonografia e Qytetit –Emër i Vjeter Theranda	700€
39	10-181-03-0038245/23 Shqipron Sopa	Organizimi i turnirit të volejbollit në nderim të volejballistit Genc Zyba	1000€
40	10-181-03-0038190/23 Delvina Bytyqi	My own path – projekt filmik	750€
41	10-181-03-0038157/23 Edona Sopaj	Në kërkimë	1000€
42	10-181-03-0038103/23 Vanesa Jakupi	Projekt Muzikor	950€
43	10-181-03-0037905/23 Alban Sopa	Përgaditja fizike dhe kondicionale për Kampionatin Botëror 2023	1000€
44	10-181-03/0037739/23 Alban Berisha	Ngritja profesionale në zhvillimin e Basketbollit	1000€
45	10-181-03-0037736/23 Shyerie Kuqi	Ligji për barazinë gjinore, informimi i femrave rreth zbatimit të tij	1000€

46	10-181-03-0037671/23 Ramadan Haxhiaj	Botimi i librave mepoezi,një për të rritur dhe një për fëmijë	1000€
47	10-184-03-0037738/23 Albion Hamitaga	Pjesmarrja ne seminarin e organizuar nga FIBA Europe – në Tiranë	500€
48	10-181-03-0037656/23 Albiona Selmanaj	Informimi rreth lokaliteteve arkeologjike përmes fletushakave	500€
49	10-181-03-0037455/23 Shpejtim Ndrecaj	Së bashkumundë të bëjmë më shumë	Individ
50	10-181-03-0037278/23 Elmi Gegaj	Promovimi i sportit në arena rajonale dhe ndërkombëtare	1000€
51	10-181-03-0036659/23 Rrahman Rexhaj	Botimi i librit : Masakrat serbe në komunën e Suharekës 1998-1999 të pagjeturit - zhdukurit	1000€
52	10-181-03-0035878/23 Denis Sofra	Vizita Studimore e monumeteve kulturore ne Kosovë nga nxënësit e komuniteteve,Rom, Ashkali dhe Egjiptian	1000€
53	10-181-03-0035593/23 Destan Sedolli	Promovimi i Suharekës përmes video dhe fotografive	500€
54	10-181-03-0035311/23 Aulona GRAISHTA	Botimi i librit artistik E nesërmja e ndritur	800€
55.	10-181-03-0036971/23 Shoqata e të Shurdhurëve Suharekë	Aktivitete për vitin 2023	Sport
56.	10-181-03-0036971/23 Jetullah Kuqi	Shfaqja e bukurive natyrore të Suharekës	1000€
57.	10-181-03-00038061/23 Arben Veselaj	Botimi i librit “Injorimi me pahir i gjuhës shqipe”	1000€

### Lista përfituese nga thirrja e dyte :

	Përfituesi	Titulli i projektit	Shuma
--	------------	---------------------	-------

1	10-181-66792/23 Klubi i Shahut Studenqani	Promovimi dhe zhvillimi i lojës së shahut	1000.00€
2	10-181-65196/23 Klubi I Futbollit Studenqani 77	Zhvillimi i 2022/2023 sezona Pranverore në kuadër të FFK të Kosoves dhe LRF Prizren	1500.00€
3	10-181-64809/23 Klubi I futbollit Suhareka 23	Mbështetje financiare për klubin sportiv-Futbolli	15.000€
4	10-181-63101/23 Klubi i Shigjetarise Luzhnica	Aplikimi i Shigjetarisë në Suharekë	800.00€
5	10-181-66988/23 Ojq IDEA	Oganzimi i aktiviteteve kulturore për fund vit	8000.00€
6	10-181-64576/23 KIUBI I Futsallit 13 Qershori	Subvencione për ojq Sportive KF 13 Qershori	2000.00€
7	10-181-64925/23 Shkolla e Futbollit Suhareka	Pjesëmarrja në turnirin mbarëkombëtare Ulpiana Cup në Durrës	1000.00€
8	10-181-64556/23 KV:GJINOCI”	Promovimi i sportit të volejbollit te femrat	3000.00 I eshte anuluar
9	10-181-66931/23 Shoqata për Kulturë dhe Art e të rinjëve dhe fëmijëve “Fidani	Monografi Studimore kushtuar veprimtarit të shquar –shqiptarë Nuredin Halit Haxhijaj ( Mulla Nura)	7000.00€
10	10-181-65244/23 Syte Kërkojnë Dtrite	Takohemi në Ekspozitë	4700.00€
11	10-181-64974/23 Sociabiliteti	Dukuritë negative pasojat dhe parandalimi i tyre	1300.00€
12	10-181-65138/23 Organizata per hulumtime ekonomike dhe sociale	Aftësim profesional në Menaxhim Binzesi, Marketing Digjital dhe Shkathësi të Buta.	1500.00€ I ka refuzuar
13	10-181-65255/23 Aeroklubi Shqiponja e Artë	Pjesëmarrja , pilotëve në gara kombëtare dhe nderkombëtare	2000.00€
14	10-181-66984/23 Ojq Shoqata e Filozofëve të Kosovës	Arti bashkëkohor dhe kultura ndërkombëtare	7000.00€

15	10-181-64707/23 Fuqizimi i Gruas dhe Rinise Suhareke	Përtej mitit dhe paragjykimeve :Cka është feminizmi?	500.00€ (I ka refuzuar)
16	10-181-64504/23 Shka Dardanët	Zhvillimi i aktivitete kulturore dhe edukimi i gjeneratve të reja	1500.00€
17	10-181-65166/23 Actibe Creativ Youth	Kampi dimëror kulturor , rinor i Suharekës	1310€
18	10-181-65078/23 Shka Jehona	Zhvillimi i jetës kulturore në Suharekë	1500.00€
19	10-181-65224/23 Kuvendi Rinor Suhareke	Hartimi i strategjisë komunale për Rini	3000.00€
20	10-181-65123/23 Kryqi i Kuq- Dega Suharekë	Rritja e numrit të vullnetarëve dhe aktiviteteve në të mirë komunitetit	2000.00€
21	10-181-64871/23 Lendrit Kolgeci	Krijimi i webfaqes për turizën në Suharekë	700.00€
22	10-181-64757/23 Genc Bekteshi	Let me tell about painting	500.00€
23	10-181-64623/23 Qamil Beqiraj	Programimi i webfaqes të Suharekës I Love Theranda	800.00€
24	10-181-64831/23 Edon Berisha	Platformë informuese	800.00€
25	10-181-64853/23 Donjete Kabashi	Etnografia shqiptare në pikature	500.00
26	10-181-66842/23 Qëndrim Kuqi	Bashkëjetesa në komunitet	1000.00€
27	10-181-6685 Ideal Çoçaj	Të rinjët dhe muzika klasike	1000.00€



28	10-181-66920/23 Bardh Gashi	Platforma online e vullnetarizmit për rini	1000.00€
29	10-181-63770/23 Jeton Kadriaj	Vetdijesimi i rinisë për menaxhimin e integruar të resurseve ujore në Komunën e Suharekës	1000.00€
30	10-181-65291/23 Albion Maliqaj	Turizmi në Komunën tonë	500.00€
31	10-181-66846/23 Lorika Sadikaj	Harta ekologjike e Suharekës	1000.00€
32	10-181-66921/23 Gentiana Gashi	Fushatë senzibilizuese kundër HIV – AIDS.	1000.00€
33	10-181-66947/23 Sedat Elshani	Trajnimi i të rinjëve me teknologji të re të zëimit-Pregaditja profesionale	1000.00€
34	10-181-63886/23 Arieta Ndrecaj	Programi edukativo arsimor për nxënësit e minoriteteve , në shkollat e ulta.	1000.€
35	10-181-64679/23 Agron Uksmajli	Këngë për dëshmorë	500.00€
36	10-181-66614/23 Arbenit Beqiraj	Gara në Motocross	1000.€
37	10-181-64994/23 Sedat Kryeziu	Promovimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës tek të rinjtë e Komunës së Suharekës	800.00€
38	10-181-66371/23 Demush Avdimetaj	Ekspozitë personale	500.00€
39	10-181-66849/23 Kaltrina Bardheci	Focus grupet	1000.€
40	10-181-65220/23 Sedat Gashi	Libri dhe Biblioteka	1000.00€
41	10-181-65068/23 Xhemajl Kolgeci	Botim Libri	500.00€
42	10-181-65219/23 Nuhi Sopa	Botim i Librit “Nuk e shkeli gjallë plisin e bardhë”	500.00€

43	10-181-64083/23 Isuf Hoxha	Vetëm sytë mos ia mbyllni	500.00
44	10-181-63669/23 Veton Sylaj	Pjesëmarrja në gara ndërkombatre në Paragllajd	1000.€
45	10-181-65194/23 Gazmend Gashi	Krijimi i filmit dokumentar	500.00€
46	10-181-64745/23 Alfinete Fondaj	Ekspozitë me punime artistike të punuar me penjë dhe gozhda	500.00€
47	10-181-66981/23 Diellzë Demaku	Fuqizimi i gruas në Komunën e Suharekës	1000.00€
48.	10-181-66983/23 Granit Hajdari	Vullnetarizmi tek te rinjët	1000.00€
49	10-181-66990/23 Arisa Zogaj	Ndikimi i rrjeteve sociale tek të rinjët	1000.00€
50	10-181-65050/23 Nuhi Sopa	Botimi i librit “Ballë për ballë bishave të egërsuara “.	500.00€
51	10-181-66979/23 Florian Beka	Bullizimi i fëmijëve nëpër shkolla fillore	1000.00€
52	10-181-65246/23 Dion Hamzaj	Loja e shahut	1000€
53	10-181-64715/23 Adem Derguti	Botimi i dy monografive	500.00€
54	10-181-64946/23 Beqir Gashi	Këngë për 13 Qershorin “Dita e Çlirimit të Suharekës”	1000.00€
55.	10-181-64983/23 Dorentina Usaj	Kampanjë vetëdisuese për parandalimin e dukurive negative	1000.00€
56.	10-181-65152/23 Enis Bytyqi	Formimi i grupit muzikor folklorik dhe rapsodik	500.00€
57.	10-181-66-965/23	Bibliotekë të lirë në natyrë	1000.00€

	Granit Trolli		
58	10-181-66967/23 Valmir Alija	Harmonia mendore-ushtrimi i artit për shendet mendot	1000.00€
59.	10-181-66971/23 Liridona Gashi	Dokumentimi i festarit ndër vite.	1000.00€
60.	10-181-66787/23 Sanije Kabashi	Botimi i librit me tregime dhe anektoda të treves së Podrimës	500.00€
61	10-118-65994/23 Agron Kelmendi	Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare në Motoçiklizëm	451€

**Mallra dhe shpezime** jane: shpenzuar rreth **75.000 euro**

#### **Inestetmet Kapitale:**

Ka filluar ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Mushtisht

Ndërtimi i Lapidarit-Muzeu në Studençan

Ndërtimi i Palestrës Sportive në Sopiçë

## **10. DREJTORIA PËR SHËNDETSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**

- Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale funksionojnë 2, (dy) sektorë si vijon;

- Sektori i Shëndetësisë
- Sektori i Punës dhe Mirëqenies Sociale

- **Departamenti i Administratës së DSHMS-së**

- Drejtori i DSHMS-së
- Zyra e Udhëheqësit
- Zyra Ligjore
- Zyra për buxhet dhe financa
- Zyra për qeshtje Administrative

- Aktivitete kryesore në DSHMS
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqeni Sociale, do të jetë përgjegjëse për këto detyra;

- hartimin e strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor që përfshinë: promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, edukimin shëndetësor, imunizimin;
- monitorimi i gjendjes shëndetësore të popullatës për ti identifikuar, analizuar shkaqet dhe zgjidhur në kohë problemet dhe rreziqet për shëndetin e popullatës;
- zhvillimin e politikave dhe planeve që mbështesin përpjekjet shëndetësore të individit dhe komunitet në përgjithësi;
- informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës rreth çështjeve shëndetësore dhe shëndetit publik;
- kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, përmes aktiviteteve të qendrës për punë sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që merren me këtë veprimtari;
- të zhvillojë buxhetin bazuar në nevojat lokale duke iu përmbajtur udhëzimeve nga MSH;
- siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore;
- raporton mbi të arriturat e objektivave të përcaktuara për Kryetarin e Komunës dhe Kuvendit të Komunës;
- zhvillimi, monitorimi dhe zbatimi i rregulloreve ekzistuese që i lëshon MSH dhe Kuvendi i Komunës;
- e drejta për të pasur, zhvilluar dhe për të përdorur pronën me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda komunës;
- monitorimi dhe bashkëpunimi me QPS në Komunë rreth përkujdesjes së rasteve sociale të popullatës së Komunës;
- bashkëpunon me MSH, vendos dhe zbaton politikat e mbrojtjes së kategorive të fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha kategoritë tjera të fëmijëve, përmes QPS, në nivelin lokal;
- mbikëqyrjes së situatës epidemiologjike në nivel të komunës;
- koordinimi dhe mbikëqyrja e punës së QKMF, QMF dhe ambulancave dhe Qendrës për Punë Sociale;
- vendos dhe mbledh bashkë-pagesat, propozon që t'i vendosë lirimet për shërbime ndaj qytetarëve nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin aplikativ;
- marrja e hapave për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare, brenda territorit të Komunës;
- përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët;
- bënë kontrollimin dhe inspektimin në lëmin e sanitarisë në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;
- do t'i ushtroj edhe kompetencat tjera që dalin nga ligjet e veçanta, statut të komunës, akte nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;

**Bazuar në detyrat dhe përgjegjësit në Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë periudhës 01.01.2023 deri me 27.12.2023, janë kryer këto shërbime:**

Nr.	Emertimi i punëve të kryera	Gjithësejë
1.	Shkresa të ndryshme si: njoftime, kërkesa, përgjigje, etj.	246

2.	Referenca pune	4
3.	Formular për botën e jashtme.	1022
4.	Kërkesa për ndihmë momentale të miratuara.	347
5.	Formular për vazhdim të pensioneve	228
6.	Kërkesa për subvencione të lindjes	17
7.	Shpallja e Konkurseve	13
8.	Përgaditja e lëndës për shpalljen e tenderit per DDD.	1
9.	Vendime , Aktvendime	32
10.	Përgaditja e lëndëve për pagesë në DSHMS	456
11.	Kërkesa për shërim banjo-klimatik të miratuara	74
12.	Përfitues të Bonus Banimit	8

Po ashtu me datë 06.03.2023 DSHMS së bashku me Kryetarin e Komunës, Kompanin Solid SH.P.K dhe Laboratorin Pathology kemi nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me nr protokoli 01-016-15551 datë 06.03.2023 për subvencionimin e 500 grave për analizën PAP TEST, DSHMS menjëher ka filluar implementimin e kësaj marrëveshje. Vlenë të theksohet se ka një interesim mjaftë të madhë për kryerjen e analizës PAP TEST.

Gjithashtu me datë 24.03.2023 kemi vizituar QMF- Bukosh, QMF-Mushtisht dhe AMF- Sopijë ku kemi biseduar me personelin e këtyre qendrave për punën dhe sfidat me të cilat ballafaqohen.



Me datë 27.03.2023 së bashku me QPS-Suharekë kemi bërë implementimin e Marrëveshje Bashkëpunimi me nr protokoli 01-104-19307 datë 21.03.2023 mes Komunës së Suharekës dhe Organizatës Qatar Charlty, objekt i së cilës ishte shpërndarja e 250 pakove ushqimore për familjet skamnore të cilat janë shfrytëzuese të ndihmave sociale pranë Qendrës për Punë Sociale.



Me datë 07.04.2023 është lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me numër protokoli 01-016-24808c ndërmjet Banjës së Kllokotit dhe Komunës së Suharekës, qellimi i së cilës është shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore – fizioterapeutike. Po ashtu është bërë edhe nënshkrimi i marrëveshjes për librezë sanitare sipas ligjit detyrave dhe përgjegjësi.

Bazuar në konkurset e shpallura nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është bërë rekrutimi i stafit shëndetësor prej 38 pozitave sipas konkurseve me nr te protokolit , si në vijim:

Vendimi me nr prot. 06-923 date 19.05.2023 - 11 Mjek të Përgjithshëm -

Vendimi me nr prot. 06-996 date 30.05.2023 - 15 Infermier të përgjithshëm

Vendimi me nr prot. 06-961 date 26.05.2023 - 5 Infermier në Urgjencë

Vendimi me nr prot. 06-985 date 30.05.2023 - 3 Teknik Medicinal në Stomatologji

Vendimi me nr prot. 06-962 date 26.05.2023 - 2 Mami Medicinale në Gjinekologji

Vendimi me nr prot. 06-991 date 30.05.2023 - 1 Teknik i RTG

Vendimi me nr prot. 06-990 date 30.05.2023 - 1 Teknik i Farmacisë





Me datë 21.06.2023 është bërë vizita në raportin e gjinekologjisë ne QKMF “REXHEP KUQI” në Suharekë, u njoftuam me angazhimin e stafit për projektin Screening-ut të qafës së mitrës dhe bazuar në marrëveshjen në më të donatorëve “Solid SHPK” dhe laboratorit “Pathology”.



Me datë 15.06.2023 është mbajtur takimi me përfaqësuesit e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) ku është diskutuar mbi fillimin e një programi të ri, për avansimin e barazisë gjinore dhe integrimin e qasjes gjithëpërfshirëse në proceset politikbërëse dhe në vendimmarrje. Qëllimi i këtij takimi ishte inicimi dhe impementimi afatgjate sa i përket barazisë gjinore mbi mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.

Po ashtu, ne kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë veprojnë ekipet mobile për trajtimin e problemeve sociale – shëndetësore të cilat ekipe gjatë kësaj periudhe kanë bërë rreth 198 vizita në teren për njerëzit në nevojë.



Gjatë kësaj periudhe është bërë implementimi i marrëveshjes me nr protokoli 01-016-74473 e lidhur me datë 24.11.2022 në mës të Komunës së Suharekës dhe Qendrës për Srehimin e Grave dhe Fëmijëve. Me datë 21.06.2023, është caktuar mbikqyrësi i kësaj marrëveshjeje i cili ka për detyrë që të shërbejë si pikë kontakti mes palëve. Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë këtij viti vazhdimisht është angazhuar në bazë të planit të Prokurimit për vitin 2023 për ndërtimin e dy Qendrave të Mjekësisë Familjare në fshatin Duhël dhe në fshatin Studençan. Së pari është bërë kërkesa në Drejtorinë për Urbanizëm për kushtet ndërtimore dhe pas aprovimit t kushteve ndërtimore ka pergaditur dokumentacionin e nevojshëm për leje ndërtimore për këto dy QMF. Po ashtu me datë 2 Gusht 2023 Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Suharekë ka shpallur Konkursin me Nr: 06-1340 për pozitat dy Doktor të Përgjithshëm. Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është angazhuar dhe ka marrë pjesë në takimet e organizuara rreth hartimit të Rregullores për tarifat në Komunën tonë, ku kemi dërguar ndryshimet e mundëshme të tarifave që janë kompetencë e Drejtorisë. Gjatë muajit Korrik është bërë dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi sipas Kontratës me Nr idetifikues 624-23-2594-2-3-6 & 624-23-17-236. Është bërë dezinfektimi në Fshatrat: Nishor, Kastërc, Breshanc, Semetisht, Dobërdelan, Samadrexhë, Studençan, Peqan, Sllapuzhan, Bllacë, Duhël, Krushicë, Javor, Mohlan dhe qyteti i Suharekës, po ashtu është bërë edhe dezinfektimi i QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve në tërë Komunën e Suharekës, është bërë edhe dezinfektimi i Objektivit të Komunës, Bibliotekës



dhe objekti i DSHMS-së. Bazuar në Ligjin për Financimin e Programeve të veqanta të Banimit Nr 03/L-164 dhe Vendimit të Asamblesë Komunale Nr 016-40551 datë 30.06.2023 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Suharekë me datë 18.07.2023 ka shpallur Thirrje Publike për Bonus Banim ku sipas Vendimit të Asamblesë familjet me kushte të renda ekonomike dhe ato të cilat nuk posedojnë shtëpi banimi do të subvencionohen me 50% të shumës së përgjithshme të qerasë, nga kjo thirrje do të përfitojnë 10 familje. Duke u bazuar në rreguloren për ndarjen e subvencioneve është bërë subvencionimi i 347 personave me kushte jo të mira ekonomike dhe me sëmundje të ndryshme, në vlerë prej 81.000.00 (trembëdhjetë e një mijë) euro, po ashtu është bërë subvencionimi i 15 rasteve të lindjeve në QKMF “ REXHEP KUQI” në vlerë prej 3750.00 (tre mijë te shtatë qindë e pesëdhjetë euro) si dhe është bërë miratimi i 74 kërkesa për shërim banjo-klimatik në vlerë prej 9 575.00 (nëntë mijë e pesë qind e shtatëdhjetë e pesë euro) . Me datë 12.12.2023 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka pranuar kërkesë me Nr. prot 06-1260 nga QKMF për shpalljen e konkurseve për tre (3) Laborant dhe tre (3) Infermier, pas pranimit të kesaj kërkesë DSHMS ka adresuar tek Zyra e Personelit kërkesën e QKMF-së për vazhdimin e procedurave të Konkursit.

### **Realizimi i buxhetit për programet e shëndetësisë Janar-Dhjetor**

1. Realizimi i buxhetit nga mjetet buxhetore (10) M & SH

**DSHMS- 99.46 %**

**QKMF – 99.99 %**

**QPS- 99.54 %**

2. Realizimi i buxhetit nga mjetet vetanake (21 ) M & SH

**DSHMS- 61.20 %**

**QKMF – 100 %**

**QPS- 0.0 %**

3. Realizimi i buxhetit nga mjetet buxhetore (10) shpz. komunale

**DSHMS-**

**QKMF – 99.93 %**

**QPS- 98.64 %**

4. Realizimi i buxhetit nga mjetet vetanake (21 ) subvencionet

**DSHMS- 99.70%**

5. Realizimi i buxhetit nga mjetet buxhetore (10) kapitalet

## **QKMF 90.52 %**

Në total realizimi i buxhetit për tri programet e shëndetësisë për të gjitha kategoritë ekonomike është **96.34 %**.

Në raport nuk është përfshi kategoria e pagave dhe meditive .

Gjithashtu në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë kryer edhe punë tjera si takime me qytetar dhe diskutimi me ta lidhur me problemet e tyre si dhe punë tjera sipas nevojës së DSHMS-së, lëshimi i dëftesave për pagesa të parapara në DSHMS.

## **RAPORT VJETOR 2023 QKMF "REXHEP KUQI" SUHAREKË**

**(Sektori i mjekësisë familjare)**

## RAPORTI I PUNES NË QKMF 2023

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSH	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
MJEKËSIA FAMILJARE	6502	5280	5126	4363	4595	4189	4831	6464	5052	5106	5209	498	61757
RADIOLOGJIA	277	293	274	162	65	250	254	189	442	315	365	292	3178
ULTRAZË	101	111	81	45	21	99	82	59	146	93	85	69	992
LEXIM R.T.G	198	177	181	109	2	139	164	126	281	205	216	182	1980
STOMATOLOGJIA	286	223	245	172	288	219	285	340	210	488	395	299	3450
URGJENCA	7175	5747	6756	6118	6140	6036	7807	10164	3020	5434	5482	4614	74493
RENTGENI	761	695	891	618	824	670	794	958	897	925	903	887	9823
MAMOGRAFI	13	14	20	12	7	16	16	22	22	36	29	19	226
LIDHTOJRA	541	410	376	536	676	594	865	949	705	710	847	703	7912
GJINEKOLOGJIA	223	208	222	190	255	164	211	226	245	305	279	209	2737
ULTRAZË	207	198	216	188	246	153	195	218	229	289	256	211	2606
CTG						1	0	1	1	0	0	0	3
LINDJE	1	0	2	1	1	3	1	4	0	0	0	0	13
LABORATORI	12721	7918	9477	9978	12486	11326	9809	9728	10546	10172	10215	9989	124365
